# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5927
E hënë, 11 nëntor 2019
çmimi 0.40 €


## Specialja i dërgon ftesë edhe Rexhep Selimit
FAQE 2




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI FAQE 4-5

# KOSOVA S'DUHET TË BËHET BLLOKUESE E PROJEKTEVE QË VIJNË NGA SHBA-ja



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se më nuk do të ketë dialog që konsiston në normalizimin e marrëdhënieve, por do të punohet për zgjidhjen politike të çështjes kyçe, që normalizimit t'i vihet kapak me njohjen e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se është edhe një variant tjetër më i pranueshëm për Serbinë, që Kosovës t'i hapet rruga për anëtarësim në OKB edhe pa njohjen formale nga Serbia, sipas modelit të koekzistimit të dy shteteve gjermane në vitet '70, që fillimisht edhe ka shërbyer si model për ta filluar dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka theksuar se te faktorët kyçë ndërkombëtarë është pjekur ideja për të bërë një shtytje të shpejtë të asaj që quhet 'arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe të obligueshme mes dy vendeve'. Sipas tij, Kosova nuk do të duhej të ishte bllokuese e projekteve që vijnë nga ShBA-ja. Maliqi ka folur edhe për formimin e qeverisë, duke thënë se çështja e presidentit nuk e ka aktualitetin e menjëhershëm

# Dukuria e parashkrimit të lëndëve, shqetësuese

Gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019 në sistemin gjyqësor janë parashkruar 4 112 "krime" të përgjithshme (3 850 lëndë me parashkrim absolut dhe 262 lëndë me parashkrim relativ). Nëse e kalkulojmë numrin e lëndëve të parashkruara me numrin e ditëve gjatë vitit 2018, i bie se mesatarisht në sistemin gjyqësor çdo ditë janë parashkruar nga 7.7 lëndë, ndërsa çdo muaj afërsisht nga 237 lëndë, është thënë në raportin e publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi "Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji vs praktika" FAQE 7

## KOSOVA REFUZON PJESËMARRJEN DHE KRITIKON SAMITIN E OHRIT



## OPINION

### MINISHENGENI DHE EUROSKEPTICIZMI NUK JANË ZGJIDHJE F. 06

Shkruan: Prof. Ass. Dr. Sabri KIÇMARI



### E LARGËT ËSHTË DITA KUR E TAKUAM PËR HERË TË PARË KADRI VESELIN F. 06

Shkruan: Bedri ISLAMI



## AKTUALE

### FIKRIM DAMKA ZGJEDHET KRYETAR I KDTP-së F. 7

## EKONOMI



### FLAMUJT E ORIGJINËS SË MALLRAVE PO 'ZHDUKEN' NË SHUMË DYQANE F. 9

### KURTI: ME FONDIN SOVRAN DO TË KRIJOJMË MUNDËSI PËR DIASPORËN F. 9

## SPORT

### GABOJNË GJILANI DHE BALLKANI, PËRFITON PRISHTINA F. 9


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

# Nuk është problem mosrespektimi i ligjit, por mbrojtja e tij



Nga Jakup KRASNIQI

Para shumë viteve, mbase edhe dekadave, pata lexuar diku në letërsinë antike greke, se qytetarët më të kulturuar i ka ai qytet (i Greqisë), qytetarët e të cilit dinë të reagojnë kur padrejtësia i bëhet tjetrit apo të tjerëve. Kjo do të thotë se është qytetari kur reagimi bëhet ndaj padrejtësisë që i bëhet tjetrit, se të reagosh ndaj padrejtësisë që ushtrohet ndaj teje është e natyrshme se, në fund të fundit, njeriu i ka dy duar për ta mbrojtur një kokë.

Nëse kemi parasysh këtë, në këto çaste që po i kalojmë, natyrshëm na shtrohet pyetja: Ku jemi ne me këtë lloj të qytetarisë?

Janë dy zhvillime që ndodhen ditët e fundit që ma risollën në kujtesë thënien e lexuar në vitet e studimeve në Universitetin e Kosovës. Zhvillimi i parë janë zgjedhjet e lira, ndërsa i dyti ftesat e reja nga dhomat e Specializuara të Prokurorisë me seli në Hagë. Jam i bindur se në të dy rastet do të duhej të kishte një reagim qytetar, e sidomos do të duhej të kishte një reagim nga komunitetet e organizuara të shoqërisë sonë, si nga komuniteti i intelektualëve, i mediave dhe shoqëria civile. Përkundrazi, ka heshtje e, në ndonjë rast, ka kritika ndaj atyre që përpiqen t'i mbrojnë ligjet në fuqi nga shkeljet e rënda që u bëhen atyre!

Gjatë gjithë viteve të lirisë e të pavarësisë, parti politike e individë me ngulm kanë bërë thirrje për sundim të ligjit, tani kur është momenti për ta mbrojtur ligjin/ligjet dhe vlerën sublime kombëtare (luftën për liri), kemi heshtje varri dhe jo vetëm tani. Në anën tjetër, kur KQZ-ja ka shkelur Ligjin për zgjedhjet së bashku me Gjykatën Supreme, duke u dhënë legjitimitet votave të paligjshme, grupet e përmendura shoqërore në masë të madhe kanë heshtur ose ndonjë teh të kritikës e kanë drejtuar ndaj atyre që kanë kërkuar e kërkojnë mbrojtjen e ligjit i cili në rastin e zgjedhjeve është shumë i qartë. Këtu nuk duhet të jetë e rëndësishme se kush po e kërkon respektimin e ligjit, por a është shkelur ligji dhe pse?

Në një situatë të tillë, mediat me kredibilitet e besueshmëri do të duhej t'i ftonin njohësit e ligjeve dhe ekspertët me përvojë që t'i jepnin mendimet e tyre profesionale.

Kushdo që e lexon Ligjin për zgjedhjet e ka të qartë se rregullat me të cilat ka filluar loja, janë ndryshuar në përfundim të saj. Kjo është e dukshme.

Reagimet në mbrojtje të ligjit/eve dhe vlerave duhet të bëhen me kohë! Përndryshe, reagimet si "kofini pas të vjelave" si duhen askujt!

# Specialja i dërgon ftesë edhe Rexhep Selimit

Rexhep Selimi, ish-anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ka bërë me dije të dielën se ka marrë ftesë nga Gjykata Speciale për t'u paraqitur në cilësinë e të dyshuarit në Holandë. Ftesë nga Specialja kanë marrë edhe ish-pjesëtarët e UÇK-së Halil Çadraku dhe Xhavit Elshani



EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 10 nëntor** - Vetëm në tri ditët e fundit Gjykata Speciale u ka dërguar ftesa tre ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rexhep Selimit (ish-anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së), Halil Çadrakut dhe Xhavit Elshanit.

Rexhep Selimi ka bërë me dije të dielën se do të merret në pyetje gjatë kësaj jave në selinë e Gjykatës Speciale në Hagë. "Të dashur miq, bashkëluftëtarë dhe qytetarë të vendit, ju njoftoj që ashtu sikurse dhe pothuajse të gjithë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe shumë luftëtarë të tjerë të lirisë, jam ftuar që të intervistohem nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në cilësinë e të dyshuarit. Intervistimi do të zhvillohet gjatë javës së ardhshme në Zyrën e Prokurorit të Specializuar në Holandë", ka shkruar Selimi në "Instagram".

Ftesë nga Specialja ka marrë edhe ish-pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Halil Çadraku. Lajmin e ka bërë me dije bashkëshortja e tij, Peka Gashi, e cila në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë publike edhe ftesën zyrtare ku shihet se Çadraku do të intervistohet në Hagë më 11 dhjetor.

Po ashtu, edhe ish-pjesëtari tjetër i UÇK-së, Xhavit Elshani, ka bërë me dije se është ftuar nga Gjykata Speciale në cilësinë e dëshmitarit. "Desha ta njoftoj opinionin, miqtë, shokët dhe bashkëluftëtarët, se sot, më datë 09.11.2019, në orë 17:50, kam marrë ftesë për t'u paraqitur në Hagë në cilësinë e dëshmitarit. Ftesën e kam pranuar fizikisht në shtëpinë time nga dy persona zyrtarë të Tribunalit të Hagës. I bindur se lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe e domosdoshme dhe si të tillë askush nuk mund ta mohojë e aq më pak ta denigrojë. Do të dëshmoj për pastërtinë e saj si e vetmja rrugë për lirinë e Kosovës", ka shkruar Elshani në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, është ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale me seli në Hagë. Ai në një konferencë për media ka bërë me dije se nga Specialja do të intervistohet më 4 dhjetor në Hagë. "Jam i bindur se edhe kjo gjykatë do ta vërtetojë luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe që do t'i ndalë goditjet ndaj të vërtetës së popullit tonë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë do t'i përgjigjem kësaj ftese më 4 dhjetor", ka deklaruar Veseli.

Prokuroria Speciale deri më tash ka ftuar për intervistim rreth 100 persona, ndër ta edhe disa prej ish-figurave të larta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që pas luftës ishin dhe janë pjesë e skenës politike të Kosovës. Në mesin e tyre: Rrustem Mustafa, Sami Lushtaku, Shukri Buja dhe Ramush Haradinaj.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Samiti i Ohrit mbahet pa Republikën e Kosovës

# Kosova refuzon pjesëmarrjen dhe kritikon Samitin e Ohrit

Maqedonia, Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina kanë mbajtur të dielën Samitin e Ohrit pa Kosovën, e cila ka refuzuar pjesëmarrjen. Përfaqësuesit e Kosovës kanë kritikuar këtë samit, duke thënë se iniciativa e minishengenit është e pakuptimtë përderisa Serbia dhe Bosnja nuk e njohin Kosovën. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka vlerësuar se Kosova nuk dëshiron ta zëvendësojë perspektivën euroatlantike me iniciativë rajonale, ndërsa lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se minishengeni është miniJugosllavi




EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Përfaqësuesit e Kosovës kanë refuzuar pjesëmarrjen në Samitin e Liderëve të Ballkanit Perëndimor në Ohër të Maqedonisë së Veriut, i cili është mbajtur të dielën. Madje presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ish-kryeministri dhe lideri i LDK-së, Isa Mustafa, kanë kritikuar këtë samit, duke thënë se kjo iniciativë rajonale është e pakuptimtë për aq kohë sa Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Presidenti Thaçi, teksa ka treguar se pse ka refuzuar pjesëmarrjen në këtë samit, ka thënë se vendimi i tij për mospjesëmarrje bazohet në disa argumente ekzistuese. "Së pari, Kosova qëllimshëm ishte anashkaluar nga Serbia në Samitin e Parë të kësaj iniciative të re rajonale. Së dyti, vizioni i vetëm i Kosovës mbetet anëtarësimi në BE dhe NATO. Prandaj, ne nuk duam që në asnjë rrethanë ta zëvendësojmë perspektivën tonë euroatlantike me çfarëdo iniciative rajonale. Dhe, së treti, kjo iniciativë rajonale është e pakuptimtë për aq kohë sa Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina nuk e njohin pavarësinë e Kosovës", ka bërë me dije Thaçi, duke shtuar se Kosova është e përkushtuar për fqinjësi të mirë dhe për heqjen e pengesave për lirinë e njerëzve dhe mallrave. "Por, Kosova nuk mund të jetë pjesë e një Samiti të tillë në të cilin marrin pjesë shtete të cilat ende nuk e njohin realitetin e Kosovës së pavarur. Ne jemi të përkushtuar që t'i tejkalojmë pengesat aktuale nëpërmjet dialogut dhe marrëveshjes për njohje reciproke. Vetëm atëherë kur të ndodhë një gjë e tillë ne do të bëhemi pjesë e iniciativave të tilla rajonale si shtete të barabarta", ka shkruar presidenti në profilin e vet në "Facebook".

Edhe më i ashpër ndaj kësaj iniciative ka qenë lideri i LDK-së, Isa Mustafa. Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar se minishengeni është miniJugosllavi. "Në cilat kuzhina po zihen projektet e Unionit Doganor të shteteve të Ballkanit Perëndimor, të Tregut të Përbashkët të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe, së fundmi, të minishengenit ndërmjet këtyre vendeve?! Në shikim të parë duken projekte atraktive, por në esencë çojnë në një Jugosllavi të re, me Shqipërinë e pa Kroacinë dhe Slloveninë. Janë ide që nuk i kemi përkrahur sa e kemi drejtuar qeverinë dhe nuk do t'i përkrahim si Lidhje Demokratike e Kosovës as në pozitë dhe as në opozitë ashtu siç nuk e përkrahim ndryshimin e kufijve shtetërorë të Kosovës", ka shkruar ai, duke shtuar se Kosova duhet ta aspirojë tregun unik evropian mbi bazën e MSA-së që rregullon edhe doganat dhe të bëhemi pjesë e Marrëveshjes Shengen, ku janë shtetet e BE-së.

Mustafa ka treguar se idetë e tilla i kishte refuzuar sa ishte kryeministër i vendit. "Marrëveshjet e minishengenit lindën kur nuk u realizua projekti i ideuar në Serbi për Unionin Doganor dhe ideja për Unionin Ekonomik të Vendeve të Ballkanit Perëndimor për shkak të kundërshtimit të Kosovës dhe të Malit të Zi. Marrëveshjet e tilla çojnë në një situatë kur tatimet në kufi, qoftë TVSh-në, tatimin doganor, akcizën do t'i mbledhë në pjesën më të madhe Serbia për Kosovën (e cila nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës), sepse e kemi kufirin më të gjatë me të, e në pjesët e tjera, Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi", ka vlerësuar Mustafa. Ai ka deklaruar se Kosova nuk kufizohet tani për tani me asnjë nga vendet anëtare të BE-së prandaj, sipas tij, me këtë marrëveshje sovraniteti do t'u kalonte vendeve fqinje. "Politikat e minishengenit i largojnë vendet e Ballkanit Perëndimor nga rruga e integrimeve evropiane dhe i çojnë në strofullin euroaziatik të dominuar nga Rusia. Janë këto manovrime të Serbisë për t'i bishtnuar detyrimet ndaj Bashkimit Evropian për normalizim të marrëdhënieve me Kosovën dhe për njohje të pavarësisë së Kosovës", ka shkruar Mustafa.

## Zaev, Vuçiq dhe Rama tregojnë për synimet e minishengenit

Liderët e Ballkanit Perëndimor kanë miratuar të dielën një deklaratë me një listë të përparësive dhe masave me të cilat synojnë ta përmirësojnë bashkëpunimin rajonal.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ka lexuar deklaratën në një konferencë për media. "Plani aksional parasheh që shërbimi kufitar të jetë funksional 24 orë brenda javës, mundësinë e lëvizjes së lirë vetëm me letërnjoftime për qytetarët e këtij rajoni. Mundëson lehtësira për transportin e mallrave, plani aksional mundëson njohjen e dokumenteve mes këtyre shteteve me qëllimin e vetëm rritjen e efikasitetet gjatë lëvizjes së mallrave dhe njerëzve", ka deklaruar Zaevi.

Edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka vlerësuar lart këtë iniciativë. "Kjo paraqet të ardhme për shtetet dhe popujt tanë. Këtu nuk ka asnjë Jugosllavi, por vetëm jetë më të mirë për qytetarët tanë, më normale, më kualitative, që më lehtë të lëvizim, ambient për jetë normale, e jo për konfrontime e urrejtje", ka thënë Vuçiq.

Ndërsa kryeministri shqiptar, Edi Rama, ka folur për mospjesëmarrjen e Kosovës në këtë takim, duke thënë se e ka të paqartë mospjesëmarrjen e Kosovës. "Nuk ka asgjë të re në këtë nismë nga ajo që jemi pajtuar në të gjitha takimet e fundit, në të gjitha nismat, e që ka të bëjë me lëvizjen e lirë të qytetarëve, pa radhë të gjata, pa kontrolle, pa ryshfete. Nuk bëhet fjalë për asnjë union doganor. Unë jam përpjekur të bëj një union doganor me Kosovën, që është refuzuar nga qeveria e ish-kryeministrit që sot flet për unionin doganor jugosllav. Kjo fare s'ka të bëjë me këtë. Këtu ka vetëm një të keqe që lehtësohen qytetarët dhe bien kauzat false", ka deklaruar Rama.

Në takimin e Ohrit kanë marrë pjesë edhe kryetari i Këshillit të Ministrave të Bosnjë Hercegovinës, Denis Zvizdiq dhe ministrja malazeze e Ekonomisë, Dragica Sekuliq. Samiti i Ohrit është vazhdimësi e takimit të liderëve të Ballkanit Perëndimor të Novi Sadit për krijimin e një minishengeni, ku nuk ishte ftuar Republika e Kosovës.




## Rama fton Kosovën në Samitin e Durrësit

Pas Samitit të Ohrit, kryeministri shqiptar, Edi Rama, ka bërë me dije se takimi i radhës do të mbahet në Durrës më 21 dhjetor. Në një konferencë për medie Rama ka thënë se në takimin e radhës dëshiron që të pranishëm të jenë edhe përfaqësuesit nga Kosova. "Ne u pajtuam që më 21 dhjetor ta zhvillojmë mbledhjen e radhës në Durrës dhe do të jetë edhe përfaqësuesi i ri i politikës së jashtme të BE-së, Borrel. Në Durrës dua që edhe Mali i Zi dhe Bosnjë Hercegovina të përfshihen. Edhe Kosova të përfshihet me të drejta të plota dhe e barabartë në këtë proces", ka thënë Rama.

Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

# Kosova s'duhet të bëhet bllokuese

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se më nuk do të ketë dialog që konsiston në normalizimin e marrëdhënieve, por do të punohet për zgjidhjen politike të çështjes kyçe, që normalizimit t'i vihet kapak me njohjen e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se është edhe një variant tjetër më i pranueshëm për Serbinë, që Kosovës t'i hapet rruga për anëtarësim në OKB edhe pa njohjen formale nga Serbia, sipas modelit të koekzistimit të dy shteteve gjermane në vitet '70, që fillimisht edhe ka shërbyer si model për ta filluar dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka theksuar se te faktorët kyçë ndërkombëtarë është pjekur ideja për të bërë një shtytje të shpejtë të asaj që quhet 'arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe të obligueshme mes dy vendeve'. Sipas tij, Kosova nuk do të duhej të ishte bllokuese e projekteve që vijnë nga ShBA-ja. Maliqi ka folur edhe për formimin e qeverisë, duke thënë se çështja e presidentit nuk e ka aktualitetin e menjëhershëm



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 NËNTOR -

**"Epoka e re":** *Z. Maliqi, Vetëvendosja dhe LDK-ja kanë përfunduar takimet për formimin e qeverisë së re dhe në ditët në vazhdim pritet të ndodhë nënshkrimi i marrëveshjes. Si e shihni funksionimin e këtij koalicioni qeverisës?*

**Maliqi:** Nëse nisemi nga procesi i harmonizimit të programit qeverisës të koalicionit Vetëvendosje - LDK, që është një risi e madhe dhe inkurajuese, mua më duket se nuk do të duhej të kihet frikë nga funksionimi i qeverisë së re. Në mediat tona gjatë bisedave për harmonizimin dhe strukturimin e koalicionit kemi pasur shumë spekulime dhe kërkime (shpikje) të pikave rreth të cilave paralajmërohej dhe dëshirohej plasja e sherrit, ose përsëritja e shantazhimeve joparimore rreth ndarjes së pushtetit çfarë i kemi parë me krijimin e qeverive të mëhershme, por nuk ndodhi ashtu. Kuptohet, deri te formalizimi i marrëveshjes duhet pritur edhe disa ditë dhe mund të ketë ndonjë element diskutabil, për shembull rreth emrave të përveçëm të ministrave dhe zëvendësve të tyre, por jo ndonjë përplasje të pariparueshme. Nëse programi që ende nuk e kemi parë, bazohet në parime dhe pushteti nuk ndahet më si më parë në feude ministrore (madje krijohej përshtypja se mbanin distancë lojaliteti ndaj kryeministrit, duke preferuar të konsultohen me 'kryeministrin' në hije të partisë që i ka deleguar), krijohet ambienti për funksionim normal të qeverisë. Kuptohet, duke ditur se këto parti kanë dallime mes vete dhe se programi bazohet në kompromise, gjithnjë do të ketë tensione dhe mospajtime rreth interpretimeve të ndryshme të programit tek administrimi konkret i çështjeve të ndjeshme. Për këtë qeveria në ardhje mbase nuk ka përvojë menaxhuese dhe mund të kërkojë ndihmë nga vendet me demokraci të avancuar rreth mekanizmave menaxhues për koalicionet çfarë është ky i yni. S'është marre të mësojmë prej tyre, për shembull se si funksionon në praktikë koalicioni aktual i të djathtës dhe të majtës në Gjermani. A ka mekanizma specifikë dhe trupa koordinues që trajtojnë mospajtimet e vogla dhe të mëdha mes partnerëve të koalicionit?

**"Epoka e re":** *A do të jetë problem ndarja e pushtetit, në veçanti posti i presidentit të vendit?*

**Maliqi:** Mendoj se çështja e presidentit nuk e ka aktualitetin e menjëhershëm, ndonëse po thuhet se do të jetë pjesë e marrëveshjes, fillimisht parimore. Ka pasur zëra që kërkonin shkarkimin e presidentit Thaçi, por mendoj se kjo nuk do të ndodhë, pos nëse vetë presidenti nuk bëhet pengesë për qeverisjen e vendit. Mua më duket se presidenti Thaçi nuk do ta bëjë këtë duke pasur përvojën e keqe dhe dëmet e 'opozitarizmit' të presidentit Ilir Meta në Shqipëri.

**"Epoka e re":** *Cilat mendoni se do të jenë anët e forta dhe të dobëta të kësaj qeverie?*

**Maliqi:** Është vështirë të bëhen analiza të tilla derisa nuk funksionalizohet qeveria, e shohim përbërjen e saj dhe zotimet konkrete që i bën rreth prioriteteve. Mund të flasim tani për mandatin që e ka marrë dhe shpresat që i ka ngjallur rreth ndryshimeve. Përparësia e qeverisë Kurti është se sjell një rifreskim të konsiderueshëm të lidershipit, më i ri për nga mosha, gjithsesi më i arsimuar dhe, shpresojmë, edhe profesionalisht më i përgatitur për punët që i presin. Ky rifreskim mund të sjellë entuziazëm dhe energji për përmbushjen e mandatit, por zakonisht kjo nuk është e mjaftueshme. Drejtuesit e rinj mund të kanë ide të mrekullueshme dhe vullnet të madh për realizimin e tyre, por duhet të janë edhe realistë, sepse shumë gjëra rreth shtetndërtimit në këto 12 vjet janë bërë mbrapsht, si improvizime, janë vendosur si staf permanent në institucionet edhe njerëz të paaftë, ka zinxhirë të tërë të posteve të rëndësishme politike, ekonomike etj., që nuk mund të zëvendësohen dhe riparohen ose aftësohen me lehtësi, ose edhe pa probleme me ligjet që kufizojnë shkarkimet e tyre. Papërgjegjësitë e qeverive të mëhershme, nepotizmi, punësimet me kritere partiake, papërgatitja dhe paaftësia e kuadrove, pastaj edhe shpenzimet e pakontrolluara të buxhetit, borxhet e papaguara që i kanë lënë pas vetes, arbitrariteti me të cilin i mbushnin bordet e institucioneve dhe agjencive shtetërore dhe publike, të gjitha këto do të reflektohen në punën e qeverisë së re, te secila ministri. T'i ndreqësh gabimet trashanike të

# e projekteve që vijnë nga ShBA-ja



mëhershme merr shumë kohë, do të ketë edhe rezistenca institucionale dhe ligjore. Kjo është një sfidë e madhe për liderët e rinj, duke u nisur nga vetë kryeministri i cili shpesh jepte premtime të nxitura për shkarkime dhe emërime, që proceduralisht nuk bëhen aq lehtë.

**"Epoka e re":** *Sa do të jenë sfiduese për qeverinë: procesi i dialogut me Serbinë, përmirësimi i gjendjes në vend si dhe përmirësimi i imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare?*

**Maliqi:** Dialogun me Serbinë mendoj se tash e tutje duhet ta quajmë negociata politike për marrëveshje finale. Nuk do të kemi më dialog që konsistonte në normalizimin e marrëdhënieve dhe lehtësimin e komunikimit, tejkalimin e pengesave burokratike dhe të tjera me qëllim që të lehtësohet jeta e qytetarëve dhe të realizohen të drejtat e ndryshme. Tani do të punohet për zgjidhjen politike të çështjes kyçe, që normalizimit t'i vihet kapak me njohjen e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë ose, si një variant përkohësisht më i pranueshëm për Serbinë, që Kosovës t'i hapet rruga për anëtarësim në OKB edhe pa njohjen formale nga Serbia, sipas modelit të koekzistimit të dy shteteve gjermane në vitet '70, që fillimisht edhe ka shërbyer si model për ta filluar dialogun Kosovë - Serbi. Mendoj se te faktorët kyçë ndërkombëtarë është pjekur ideja për të bërë një shtytje të shpejtë të asaj që quhet 'arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe të obligueshme mes dy vendeve'. Së voni ShBA-ja e ka vendosur në agjendën e vet për rajonin dhe kjo nismë nuk mund të neglizhohet nëse, siç po thuhet, nga Uashingtoni i kemi paralajmërimet se nuk duhet të humbet ky shans, sepse amerikanët mund ta humbin interesin që edhe më tej të merren me 'punët e pakryera të Evropës. Si edhe në rastin e disa nismave më të hershme të ShBA-së, në Rambuje ose te procesi i Vjenës, Kosova nuk do të duhej të ishte bllokuese e projekteve që vijnë nga ShBA-ja. Qeveria Haradinaj me kokëfortësi dhe shkurtpamësi nuk e pranoi testimin e këtij opsioni duke pezulluar taksën, me çka u dëmtuan raportet tona me aleatët kryesorë perëndimorë. Sot situata është më e komplikuar, por duhet të kihet parasysh se edhe nëse negociatat e riprojektuara nuk sjellin rezultatet, duhet t'i ruajmë raportet e afërta me ShBA-në dhe fuqitë evropiane që e kanë njohur Kosovën.

**"Epoka e re":** *Çfarë pritjesh keni nga legjislatura e shtatë e Kuvendit si dhe përballja e qeverisë Kurti me opozitën PDK - AAK?*

**Maliqi:** Kosova nuk është pa përvojë në tranzicionin e pushtetit, dhe mirë është që koalicionin në ardhje do ta kemi kombinim të një force aktiviste që e ka filluar rrugëtimin politik me ide revolucionare dhe radikalizëm (të zbutur në ndërkohë) me partinë më të vjetër e me përvojë më të madhe, pasi që edhe ajo e ka nisur rinovimin sinjifikativ me kuadro. Nëse LV dhe LDK ndërtojnë raport të shëndoshë mes vete rreth çështjeve madhore, kjo do të kontribuojë edhe në shëndoshjen e atmosferës së përgjithshme në Kuvend, përfshirë edhe opozitën. PDK-ja, tani në opozitë, është treguar shembullore me rastin e humbjes së pushtetit. Ka gjasa se ajo për çështjet madhore që na presin do ta mbajë qëndrimin e opozitës konstruktive, çka do t'i ulte shqetësimet nga pasojat e mosunitetit rreth asaj se çka mund të sjellë finalja e negociatave me Serbinë. Kushdo që do t'i udhëheqë negociatat, e di se fjalën e fundit për ratifikimin e marrëveshjes e ka Kuvendi. Besoj se kjo legjislaturë e Kuvendit nuk do të jetë trup i manipulueshëm për votime joparimore dhe dëmtuese për Kosovën, por një Kuvend i përgjegjshëm. Nga ana tjetër, zgjedhjet e 6 tetorit kanë krijuar një standard të ri për llogaridhënie të pushtetit në përfundim të mandatit, kështu që PDK-ja, tani në opozitë, me apo pa AAK-në në krah, nuk do t'ia fal papërgjegjësitë dhe dështimet e qeverisë së re për trajtimin e çështjeve për të cilat ka dhënë premtime të mëdha. Përkundrazi, do ta survejojë çdo fjalë dhe veprim të saj. Duke e ditur karakterin e tij të autoritetit imponues që nuk zmbrapset lehtë nga idetë dhe synimet e veta, Albin Kurti si kryeministër nuk do ta ketë punën aspak të lehtë as me partnerin e koalicionit e as me opozitën. Ai duhet ta kuptojë se pushteti i tij është i ndarë, i ka vetëm pak më shumë se 1/3 e votës së sovranit, sepse 1/3 tjetër është e LDK-së, kurse 1/3 e pak më shumë do të jetë dispozitë e opozitës. Mund t'i ndodhë që ndonjëherë ta ketë më të lehtë ballafaqimin me argumente parimore me ndërkombëtarët sesa me faktorët vendorë vendimmarrës. Po, nejse, kjo është sfida të cilën e ka synuar dhe e ka fituar me meritë, dhe tani duhet të tregohet se e ka kalibrin e politikanit të zot në praktikë.

# Minishengeni dhe euroskepticizmi nuk janë zgjidhje



**Shkruan:**
**Prof. Ass. Dr. Sabri KIÇMARI,** *Profesor në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës*

Dy takime të nivelit të lartë të përfaqësuesve të tri vendeve të Evropës Juglindore, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë, fillimisht në Novi Sad e dje edhe në Ohër, kanë rezultuar me një shumësi interpretimesh nga më të ndryshmet: si rikthim drejt një Jugosllavie të re dhe si një platformë minishengeni. Këto takime shtrojnë disa pyetje sfiduese, të cilat mund të përmblidhen në tri pyetje themelore, të cilat dëshirojmë t'i shtrojmë që në fillim: A po vazhdon Evropa Juglindore të sillet si Ballkan? A perceptohen vendet e rajonit tonë si Ballkan, apo si Evropë Juglindore? Ose thjeshtë: A po sillen vendet tona si në histori, apo kanë mësyrë në ardhmëri? Evropa Juglindore, e quajtur më shumë politikisht se sa gjeografikisht Ballkan, ka ndryshuar në tridhjetë vitet e fundit. Muri ndarës ideologjik është tejkaluar. Asnjë nga vendet e rajonit tone nuk preferon sistemin njëpartiak dhe ekonominë e kontrolluar të tregut. Rreth 75 milionë qytetarë të rajonit janë bërë më mobil: lëvizin nga shteti në shtet, bëjnë biznes dhe kalojnë pushimet në bregdet. Pesë nga vendet e Evropës Juglindore janë pranuar në Bashkimin Evropian: Rumania, Bullgaria, Greqia, Kroacia dhe Sllovenia, përderisa të gjitha janë në rrugë për t'u integruar në BE: me status kandidati Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe kandidat potencial Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova. Por, përkundër këtij trendi pozitiv në Evropën Juglindore, ka edhe një trend tjetër, i cili lehtë mund të shkaktojë rikthimin e historisë në Ballkan: nacionalizmi ekstrem, fundamentalizmi religjioz dhe rikthimin e influencës ruse në rajon. Edhe pse në rrafshin e sigurisë shumica absolute e vendeve të rajonit janë anëtarësuar në NATO: Turqia, Rumania, Bullgaria, Greqia, Kroacia, Sllovenia, Shqipëria dhe Mali i Zi, pastaj Maqedonia dhe Kosova kanë orientim të qartë pro-NATO, përderisa Bosnja dhe Hercegovina është e ndarë në dysh në mes të Lindjes dhe Perëndimit, është Republika e Serbisë ajo që preferon aleancë ushtarake me Rusinë, ka hapur një Qendër për Mbrojtjen Civile në Nish, të pajisur me aeroplanë për veprim në gjendje gatishmërie "për raste të jashtëzakonshme", blenë aeroplanë ushtarak nga Rusia dhe organizon ushtrime ushtarake me Rusinë dhe Bjellorusinë. Në rast se pretendimi rus për ndikim vazhdon me intensitetin aktual, rajoni i Evropës Juglindore mund të shndërrohet lehtë sërish në Ballkan, ashtu siç ky nocion nënkuptohet te vendet e Perëndimit: si rajon i ndarjes, prapambetjes, korrupsionit, nacionalizmit, konfliktit dhe luftës. Ose thënë simbolikisht me gjuhën e Churchillit: Do të kthehej sërish në zorrën qorre të Evropës. Vendet e Evropës Juglindore gjenden në qendër të një udhëkryqi të trefishtë gjeografik, kulturor, religjioz dhe politik. Ky rajon gjendet gjeografikisht në mes të Azisë dhe Evropës. Në të kaluarën Perandoria Romake dhe ajo Bizantine i kanë thyer mes vete shpatat për ndikim në këtë rajon, ashtu siç kanë bërë më vonë Perandoria Osmane, Republika e Venedikut, Perandoria Austro-Hungareze dhe Rusia. Në rrafshin religjioz shumica e vendeve të Evropës Juglindore i përkasin religjionit ortodoks, edhe pse shkalla e praktikimit të tij real është më shumë simbolike. Një e katërta e banorëve të rajonit i përkasin religjionit islam, me të gjitha variantet e tij sektare, përderisa pjesa tjetër i përket fesë së krishterë. Por, po ashtu në këtë rajon pati lindur shteti i pare ateist në botë. Pas procesit të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë njerëzit, kombet, grupet etnike u orientuan drejt identitetit kombëtar si identiteti primar identifikues historik, gjuhësor dhe kulturor. Ky proces u shoqërua me rritjen enorme të patriotizmit dhe nacionalizmit, gjë që si rrjedhim pati lindjen e shteteve të reja, por edhe katër luftëra në rajon, pastrim etnik, dhunime, vrasje në masë dhe gjenocid. Shtetet shumetnike u shpërbënë dhe nga to lindën shtete të reja, me kufij të rinj ndërshtetëror, kulturor dhe kombëtar. Zhvillimet politike të 30 viteve të kaluara në rajonin e Evropës Juglindore kanë sjell në pah dy trendë themelore veprimi, që mund të shpjegohen me dy drejtimet themelore të analizës së marrëdhënieve ndërkombëtare: në njërën anë, ka pasur një proces të qartë veprimi realist, ku aktorët e rinj kombëtar, në rrjedhë të shpërbërjes së shteteve shumetnike, u orientuan në veprime në mbrojtje të interesave kombëtare, për të krijuar shtetet kombëtare, me qëllim të maksimalizimit të dobisë, në një ambient kaotik dhe anarkist, të krijuar pas rënies së sistemit socialist në Evropën e Lindjes; dhe në anën tjetër, është shfaqur kundërveprimi liberal në marrëdhëniet ndërkombëtare, kur aktorët ndërkombëtar u aktivizuan, edhe pse me vonesë, në mbrojtje të të drejtave të njeriut, me qëllim të shmangies së gjenocidit në Bosnje dhe Kosovë, duke përdorur edhe forcën e armatosur kundër Serbisë, e cila shkaktoi katër luftëra agresive kundër vendeve fqinje brenda shtatë viteve. Por, a e kanë gjetur rrugën prosperuese vendet e Evropës Juglindore? Procesi i një rilindjeje kulturore, tolerance, me respekt të ndërsjellë mes vete nuk ka zënë ende vend në vetëdijen e popujve të rajonit, përkundër investimeve të shumta të BE dhe SHBA. Disa prej konflikteve kanë mbetur ende si konflikte të ngrira. BE duket se nuk e ka kuptuar këtë gjë. Prandaj pati të drejtë presidenti i Komisionit Junker, kur e kualifikoi "një gabim të rëndë historik" vendimin e Francës, Holandës dhe Danimarkës për të bllokuar hapjen e negociatave për pranimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në BE. Edhe kancelarja gjermane Angela Merkel ka shfaqur zhgënjimin e saj për këtë vendim bllokues të këtyre tri vendeve. Vendimet e tilla shkaktojnë vetëm zhgënjim. Në një situatë të tillë zhgënjimi, kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe kryeministri maqedonas Zoran Zajev vendosën t'i bashkëngjiten iniciativës së presidentit serb Aleksandër Vuçiq për një strukturë të re rajonale. Është një lëvizje emocionale dhe jo e menduar mirë në rrafshin strategjik. Është një lëvizje tipike ndarëse ballkanike. Fakti se iniciativës nuk ju kanë bashkuar Kosova, Mali i Zi dhe Bosnja, mund të kualifikohet si një lëvizje prej të dëshpëruarish. Dëshpërimi në raste të tilla nuk duhet të jetë motivi lëvizës vendimmarrës. Shqipëria dhe Kosova nuk duhet të shkojnë ndaras në projekte rajonale. Është interes strategjik maksimalizimi i fuqisë ndikuese në rajon. Kjo gjë mund të bëhet vetëm përmes një koordinimi dhe hapërimi të menduar mirë. As minishengeni dhe as euroskepticizmi populist nuk janë zgjidhje. Orientimi strategjik nacional i shqiptarëve është Evropa dhe Perëndimi. Rikthimi te idetë për një strukturë të re integruese ndërballkanike është shmangie prej të dëshpëruari nga orientimi strategjik evropian. Për ta përshpejtuar procesin e integrimit në BE dhe NATO, Shqipëria dhe Kosova duhet të kenë çaste serioze të reflektimi diplomatik, duke vënë në zbatim artin e negocimit dhe diplomacinë me sens dhe durim.



## Fikrim Damka zgjedhet kryetar i KDTP-së

**PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER)** - Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) ka mbajtur Kuvendin e Tetë Zgjedhor, në të cilin Fikrim Damka është zgjedhur kryetar i KDTP-së pas 20 vjetësh.

Ministri në detyrë i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ka qenë drejtuesi i parë i Partisë Demokratike Turke të Kosovës që nga themelimi i saj.

Jagxhillari gjatë dorëzimit të detyrës që ka ushtruar për rreth 20 vjet ka falënderuar të gjithë delegatët e pranishëm në Kuvendin Zgjedhor dhe ka dorëzuar detyrën e kryetarit të zgjedhur, Fikrim Damkës, i cili njëkohësisht është deputet shumëvjeçar në Kuvendin e Kosovës.

Në këtë Kuvend ishin të pranishëm ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, konsulli i Përgjithshëm i T. C Prizren, Serdar Ayzayd?n, kryetari i VAKAT-it, Rasim Demiri, nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Kollqaku, kryetari i Partisë Demokratike Maqedonase, Beycan Ilyas dhe deputeti Yusuf Hasani, dhe përfaqësues të OJQ-ve etj.

Kryetari Damka është zotuar se prioritetet në qeverisjen e re të KDTP-së do ta ketë qytetarin.



# Dukuria e parashkrimit të lëndëve, shqetësuese



**Gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019 në sistemin gjyqësor janë parashkruar 4 112 "krime" të përgjithshme (3 850 lëndë me parashkrim absolut dhe 262 lëndë me parashkrim relativ). Nëse e kalkulojmë numrin e lëndëve të parashkruara me numrin e ditëve gjatë vitit 2018, atëherë i bie se mesatarisht në sistemin gjyqësor çdo ditë janë parashkruar nga 7.7 lëndë, ndërsa çdo muaj nga afërsisht 237 lëndë. Kështu është thënë në raportin e publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi "Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji vs praktika"**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, të dielën ka mbajtur konferencë për media, në të cilën ka publikuar raportin "Krimet e përgjithshme në Kosovë, ligji vs praktika".

Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i IKD-së, ka thënë se raporti analitik është si rezultat i monitorimit dhe hulumtimit sistematik të rasteve në të gjitha Departamentet e Përgjithshme (DP) - Divizionet Penale të të gjitha Gjykatave Themelore (GJTh), në tërë territorin e Kosovës, përfshirë edhe degët e tyre. "IKD-ja gjatë kësaj periudhe kohore ka monitoruar gjithsej 2 694 seanca, ku përfshihen 2 015 lëndë penale. Një ndër problemet më të mëdha në këtë departament shfaqet dukuria e parashkrimit të lëndëve", ka thënë Miftaraj.

Gzime Hashani, hulumtuese në IKD, ka pohuar se KGjK-ja ka dështuar t'i zbatojë politikat e veta sa i përket reduktimit të lëndëve në gjykatat themelore. "Ndonëse divizionet penale vazhdojnë të përballen me numër të madh të lëndëve, këto divizione kanë hyrë në 'binarë' të stabilizimit. Me këtë ritëm të gjitha lëndët e pazgjidhura të cilat barten vit pas viti do të zgjidhen për rreth tre vjet", është shprehur ajo.

Hashani ka shtuar se sa i përket performancës së divizioneve penale sipas gjykatave, rezulton se në vitin 2018 prin Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Pejë me 51 për qind të lëndëve të zgjidhura, ndërsa përqindjen më të vogël në këtë rast e ka Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Ajo ka theksuar se përqindja e ulët e Gjykatës Themelore në Prishtinë ndërlidhet edhe me numrin e madh të lëndëve me të cilat është e ngarkuar kjo gjykatë. "Gjatë vitit 2018, mesatarisht secili gjyqtar ka zgjidhur nga 303.4, që i bie se gjyqtarët e DP-ve të GjTh-ve gjatë vitit 2018 kanë tejkaluar normën orientuese të përcaktuar nga KGjK-ja, duke kryer nga 11.4 lëndë më shumë", ka deklaruar Hashani, sipas së cilës, në raportet e KGjK-së mbi performancën individuale të gjyqtarëve, IKD-ja ka gjetur se ka disbalancë të madh në mes të gjyqtarëve për nga numri i lëndëve të kryera.

Hulumtuesja Hashani ka theksuar se ndër problemet më të mëdha në departamentet e përgjithshme mbetet dukuria e parashkrimit të lëndëve penale. "Gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, në sistemin gjyqësor janë parashkruar 4 112 'krime' të përgjithshme (3 850 lëndë me parashkrim absolut dhe 262 lëndë me parashkrim relativ). Nëse e kalkulojmë numrin e lëndëve të parashkruara me numrin e ditëve gjatë vitit 2018, atëherë i bie se mesatarisht në sistemin gjyqësor çdo ditë janë parashkruar nga 7.7 lëndë, ndërsa çdo muaj afërsisht nga 237 lëndë. Ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 çdo ditë janë parashkruar nga 7 lëndë, apo nga 211 lëndë në muaj. Parashkrimi amniston kryerësit e veprave penale dhe dëmton interesat e palëve të dëmtuara", ka thënë Hashani.

Sa iu përket prokurorive, hulumtuesja Hashani ka thënë se statistikat e KPK-së pamundësojnë analizimin e trendëve të efikasitetit në këto departamente, duke vështirësuar informimin e saktë të publikut rreth punës së këtij institucioni. "KPK refuzon që ta bëjë publike punën individuale të secilit prokuror dhe, po ashtu, nuk ofron të dhëna mbi numrin e rasteve të parashkruara në sistemin prokurorial, të cilat në rastet që IKD-ja i monitoron, i evidenton dhe raporton", ka thënë ajo. Sipas Hashanit, në Prokuroritë Themelore (PTh), rezulton se mesatarisht prokurorët kanë tejkaluar dyfishin e normës vjetore, duke kryer nga 305 lëndë më shumë sesa norma orientuese. "Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka qenë prokuroria më efikase, ku secili prokuror mesatarisht ka zgjidhur nga 890 lëndë. Prokuroria më joefikase ka qenë Prokuroria Themelore e Prishtinës, ku secili prokuror mesatarisht ka kryer 388 lëndë gjatë vitit 2018", ka deklaruar Hashani.

Një shqetësim tjetër që ka ngritur hulumtuesja Hashani ka të bëjë me dështimin e ankesave të Prokurorisë në Gjykatën e Apelit. "Në vitin 2018 prokurorët e Departamenteve të Përgjithshme kanë parashtruar gjithsej 426 ankesa, 82 prej të cilave janë aprovuar nga Gjykata e Apelit, derisa 169 ankesa të tjera janë refuzuar nga Gjykata e Apelit. Ndërsa në gjashtëmujorin e parë 2019, prokurorët e Departamenteve të Përgjithshme të Prokurorive Themelore kanë parashtruar gjithsej 673 ankesa, 188 prej të cilave janë aprovuar nga Gjykata e Apelit, derisa 354 ankesa të tjera janë refuzuar nga Gjykata e Apelit", ka treguar ajo.

Hulumtuesi Mirvet Thaqi ka prezantuar gjetjet e veçanta të raportit. Thaqi ka thënë se nga rastet e monitoruara rezulton se Prokuroria ka kërkuar sekuestrimin e pasurive vetëm në 53 raste, ndërsa fare nuk ka kërkuar në 1 962 raste të tjera që paraqet, sipas tij, një dështim të prokurorëve në luftimin e pasurive të përfituara përmes aktiviteteve kriminale. Sipas tij, kohëzgjatja e një rasti në Prokurori nga data e parashtrimit të kallëzimit penal e deri në ngritjen e aktakuzës është 285 ditë. "Gjykatave themelore vetëm për caktimin e shqyrtimit fillestar pas ngritjes së aktakuzës i janë nevojitur mesatarisht 619 ndonëse, sipas Kodit të Procedurës Penale Gjykata, obligohen që seancën fillestare ta mbajnë brenda 30 ditësh pas ngritjes së aktakuzës", ka thënë ai.

Thaqi ka pohuar se IKD-ja ka gjetur se ekziston një tendencë e gjykatës për t'i fshehur nga opinioni publik lëndët ku në cilësinë e të akuzuarve paraqiten persona me ndikim në jetën politike dhe publike. "IKD-ja ka vërejtur se disa raste mbahen qëllimisht të mbyllura për publikun si pushimi i gjykimit ndaj Frashër Krasniqit dhe 21 aktivistëve të LV-së, aktakuza për rastin 'Fondi 3 %', rasti 'Spitali', pushimi i procedurës ndaj ish-këshilltares së ish-ministrit Blerand Stavileci etj", ka treguar ai.

Dukuri tjetër që, sipas hulumtuesit Thaqi, është vërejtur gjatë monitorimit të IKD-së, është ngritja e aktakuzave nga prokurorët për vepra penale të rëndësisë së vogël. "Ka pasur aktakuza dhe dënime për qytetarë të cilët kanë vjedhur disa pula e gjela, apo ka pasur dënime me kusht për blerje të akumulatorit në vlerë prej pesë eurove. Me këtë qasje të prokurorëve dhe gjykatësve për ngritjen e aktakuzave të rëndësisë së vogël dhe dënimeve joadekuate, thjesht sistemi i drejtësisë nuk arrin të japë përgjigje për dukuritë negative në rritje", ka thënë Thaqi.

Thaqi ka thënë se IKD-ja ka ofruar një sërë rekomandimesh për adresimin e problemeve të identifikuara gjatë monitorimit. Ndër të tjera, ai ka thënë se rekomandojnë që KGjK-në dhe KPK-në t'i rianalizojnë rregulloret mbi normat orientuese, në mënyrë që të krijohen indikatorë të saktë mbi matjen e efikasitetit të secilit gjyqtar dhe prokurorë, ndërsa këto institucione u rekomandua që ta rrisin llogaridhënien ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët nuk respektojnë afatet ligjore për trajtimin e rasteve në krimet e rënda.

# Flamujt e origjinës së mallrave po "zhduken" në shumë dyqane

Inspektorati i tregut ka gjobitur rreth 150 biznese të cilat nuk e kanë respektuar vendimin për vendosjen e flamujve të origjinës së produktit, ka bërë me dije kryeinspektori i Tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Lulzim Syla. Ai ka treguar se inspektorati i kësaj ministrie ka vetëm 14 inspektorë, kurse për një monitorim të mirëfilltë të këtij udhëzimi, Syla thotë se duhet të angazhohen edhe inspektorët komunalë


Radio Evropa e Lirë (RFE/RL)

**Prishtinë, 10 nëntor** - Shumë subjekte afariste në Kosovë nuk po e zbatojnë në masën e duhur udhëzimin administrativ që i obligon operatorët ekonomikë ta vendosin flamurin e origjinës së produktit nëpër dyqane, në mënyrë që konsumatorët të njoftohen me origjinën e mallrave që blejnë. Për shkak të neglizhencës së zbatimit të këtij udhëzimi, vazhdon shqiptimi i gjobave nga inspektorati i tregut.
Ky vendim ka hyrë në fuqi në muajin shkurt të këtij viti, pak kohë pas vendosjes së taksës doganore 100 për qind për të gjitha produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina.
Zyrtarë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë thonë se po e monitorojnë zbatimin e këtij udhëzimi por, sipas tyre, numri i vogël i inspektorëve në terren mund të ndikojë që operatorët ekonomikë të mos i përgjigjen gjithmonë udhëzimit. Megjithatë, kryeinspektori i Tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Lulzim Syla, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", thotë se Inspektorati i Tregut ka gjobitur rreth 150 biznese të cilat nuk e kanë respektuar vendimin për vendosjen e flamujve të origjinës së produktit.
Ai tregon se inspektorati i kësaj ministrie ka vetëm 14 inspektorë, kurse për një monitorim të mirëfilltë të këtij udhëzimi ai thotë se duhet të angazhohen edhe inspektorët komunalë. "Aty ku vërehet se nuk kanë vendosur flamuj, gjoba lëshohet menjëherë prej 1 000 eurosh. Inspektorati i sigurisë në kuadër të MTI-së ka dhënë 74 gjoba, kurse Inspektorati i Tregut ka gjobitur 72 subjekte. Pra, në përgjithësi janë shqiptuar 146 gjoba vetëm për mosvendosjen e flamujve të origjinës", ka bërë me dije Syla.
Në bazë të udhëzimit, në rast se bizneset nuk e respektojnë udhëzimin administrativ, atëherë mund të pasojnë gjoba nga 1 000 deri në 20 mijë euro. Nëse bizneset nuk kanë arritur t'i vendosin të gjithë flamujt, por vetëm pjesërisht, atëherë dënohen me 1 000 euro. Por, nëse kanë anashkaluar komplet procesin e vendosjes së flamujve, atëherë lëndët do të procedohen në gjykatat e Kosovës, ku dënimi mund të arrijë prej 5 deri 20 mijë euro.
"REL" ka evidentuar disa raste në qendra tregtare në Prishtinë, ku nuk figuron flamuri i origjinës pranë produktit përkatës. Një gjë të tillë e pohojnë edhe disa qytetarë.
Blerina Fejza, konsumatore në njërën nga dyqanet në kryeqytet, thotë se shpesh has në produkte pa flamuj të origjinës. "Sa dola prej dyqanit dhe pashë se të gjitha produktet nuk i kanë flamujt e origjinës. Më herët i kanë pasur më shumë, por tash kishte shumë mungesa", ka thënë Blerina nga Prishtina.
Edhe udhëheqësi i Organizatës Joqeveritare "Konsumatori", Selatin Kaçaniku, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se, përveç mosvendosjes së flamurit të origjinës afër mallit të ekspozuar për shitje, në shumë raste flamuri i shtetit nuk përkon me origjinën e mallit në vitrinat e shitjes.
Mospërputhja e flamurit të shtetit me origjinën e produktit, sipas Kaçanikut, kryesisht ndodh kur kemi të bëjmë me prodhimet nga Serbia. "Ato pak subjekte afariste që e respektojnë flamurin kanë të bëjnë me një konflikt të natyrës tjetër, sepse e vendosnin flamurin të cilin u konvenonte. Ose është flamur i origjinës së importit, por nuk është flamur i origjinës së produktit. Në këtë mënyrë ata (afaristët/bizneset) e mashtrojnë, e vënë në lajthitje qytetarin konsumator dhe natyrisht se shkelet udhëzimi", ka deklaruar Kaçaniku.
Udhëzimi administrativ për vendosjen e flamujve të origjinës së produktit pati hyrë në fuqi pak kohë pas vendosjes së taksës 100 për qind për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina.
Vendosja e taksës 100 për qind vazhdon të jetë në fuqi. Qeveria në largim e Kosovës deri më tani nuk është zmbrapsur nga ky vendim, edhe pas shumë kërkesave nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për pezullimin apo anulimin e kësaj takse. Kurse dy partitë politike që aktualisht janë në bisedime për formimin e Qeverisë së ardhshme të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura më 6 tetor dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, si partia e dytë e dalë nga këto zgjedhje, kanë paralajmëruar se taksa doganore ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës do të zëvendësohet me reciprocitet.

# Matoshi në Slloveni: Kosova të jetë përfituese e fondeve mjedisore



**Bled, 10 nëntor (ER)** - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, me ftesë të ministrit slloven të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Simon Zajc, po qëndron në Bled, për të marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare "Ekonomia Qarkore në Rajon". Në kuadër të kësaj konference ministri Matoshi ka zhvilluar takim bilateral me ministrin Zajc, të cilin e ka falënderuar për ftesën dhe mundësinë që i është krijuar Republikës së Kosovës që të jetë e barabartë në nismën e re regjionale për ekonominë qarkore. "Kjo nismë për rajonin tonë do të ishte e pranueshme dhe e mirëpritur që të drejtohej nga Sllovenia", ka deklaruar Matoshi.
Ai ka falënderuar shtetin slloven për mbështetjen që po i jep vendit tonë dhe ka kërkuar që ministri slloven ta ushtrojë ndikimin që Republika e Kosovës të jetë përfituese e fondeve mjedisore që ndahen nga programet e Kombeve të Bashkuara. Në këtë konferencë ku po marrin pjesë shumë shtete të ndryshme të BE-së dhe Ballkanit, ministri Matoshi ishte folës në njërin nga panelet e organizuara. "Republika e Kosovës është e gatshme dhe e përgjegjshme që ta jap kontributin e vet në nismat rajonale për ekonominë qarkore dhe për një mjedis sa më të pastër, por kërkojmë që të mos përjashtohemi nga fondet që ndërlidhen me mjedisin, e sidomos nga ato që janë në programet e OKB-së. Çështjet e pazgjidhura politike nuk duhet të jenë pengesë për këtë. Përjashtimi i një vendi nga këto fonde nuk sjell rezultat as në vendet fqinje sepse ajri i ndotur, ujërat e ndotura nuk njohin kufijtë", ka thënë ministri Matoshi. Ai ka folur edhe për të arriturat dhe sfidat që ka Republika e Kosovës në çështjet mjedisore, si në menaxhimin e mbeturinave, ujërat e zeza, ndotjen e ajrit, rezervat ujore, përafrimin e legjislacionit me BE-në dhe çështje të tjera.
Gjatë konferencës ministri Matoshi ka takuar edhe ish-komisionarin për mjedis në BE dhe tani bashkëkryesues në UNEP, Janez Potocnik, profesorin Jeffrey Herrick nga Departamenti Amerikan i Bujqësisë, si dhe shumë ministra, zëvendësministra e zyrtarë të lartë të ministrive të mjedisit nga vende të ndryshme të Evropës.

# Kurti: Me Fondin Sovran do të krijojmë mundësi për diasporën



**Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka marrë pjesë në Kongresin e Dytë Ekonomik të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Gjermani. Me këtë rast, ai ka bërë me dije se me Fondin Sovran Investues do të krijojnë mundësi për diasporën që të blejë aksione në të ardhmen dhe kësisoj ajo të bëhet aksionare e aseteve publike që mundësojnë zhvillimin ekonomik**

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 NËNTOR- Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka marrë pjesë në Kongresin e Dytë Ekonomik të Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Gjermani. Ai ka thënë se si shtet duhet të mendojnë që të kujdesen për diasporën. "Emigrimi nuk ka qenë vendim i lehtë për askënd. Prindërit që vendosin të jetojnë larg fëmijëve e fëmijë që vendosin të jetojnë larg prindërve vështirë të thuhet se këtë, ndonjëri, ndonjëherë e bëri nga vullneti", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se e di se nuk është lehtë të ikësh nga vendi yt dhe të shkosh në një vend të huaj e të përballesh me sakrificën larg familjes, me vështirësitë e një populli në një vend të huaj. Por, sipas tij, ky është realiteti. "Ne nuk mund ta kthejmë kohën pas, por mund ta fitojmë kohën që kemi përpara. Prandaj është mirë që jam këtu sot me juve sepse mund të them disa fjalë që mund t'i kthejmë bashkë edhe në veprime konkrete për të fituar këtë të ardhme", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se diaspora kontribuon në vendin ku jeton sepse paguan taksat dhe detyrimet, por paguan edhe në vendin prej nga vjen. "Ju nuk na sillni vetëm para të gatshme, nuk na sillni vetëm makina e nuk na i paguani vetëm dasmat e ahengjet, e shëndetësinë e familjarëve tuaj e tonë. Ju sillni ide, kulturë dhe shkathtësi e njohuri që i merrni nga vendet më të zhvilluara e të cilat mungojnë në vendin tonë. Pra, ju jeni pasuria jonë që çdo popull do ta kishte lakmi. Por, sikur çdo pasuri tjetër, edhe kjo e juaja është e tillë vetëm nëse ne dimë ta përdorim për të mirën e përbashkët", është shprehur lideri i LV-së.

Kurti ka pohuar se shkathtësitë e njohuritë që ka diaspora do të mundësojnë që të kthehen në biznese të reja, në investime strategjike, e në udhëheqje ndërmarrjesh të cilat do të hapin vende të reja pune, por që kjo do të ndikojë edhe në lidhjen e bashkatdhetarëve më shumë me atdheun. "Shtetet e fuqishme i kanë ambasadat e fuqishme. Ne nuk jemi ende shtet i fuqishëm e nuk i përballojmë dot siç duhet e sa duhet ambasadat, por jemi komb i madh e i shpërndarë. Fati në fatkeqësinë tonë kombëtare të emigrimit është se sot jemi kudo, por jemi edhe shumë të ndarë. Ne duhet të bëhemi bashkë, ne duhet të investojmë në atë që na bashkon: në gjuhë, në histori, në letërsi, në muzikë, në art e në kulturë. Prandaj në qeverisjen tonë do t'i krijojmë qendrat kulturore për të cilat shteti kujdeset që gjuha, kultura dhe historia e brezave të mësohen nga fëmijët kudo. Ambasadori më i mirë e më i fuqishëm është vetë diaspora jonë. Prandaj sot krenohemi me Dua Lipën e Rita Orën, Granit Xhakën e Rene Rexhepin. Ata janë pjesë e kombit tonë", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se diasporën e shohin edhe si vlerë ekonomike. "Çdo vit diaspora dërgon 1 miliard euro në remitanca. Kur llogariten edhe makinat, dasmat e shpenzimet e pushimit kjo shifër shkon gati sa buxheti i shtetit tonë. Ky është kapital të cilin secili shtet do ta kishte zili. Dhe në një botë ku njerëzit, shërbimet e të mirat udhëtojnë më shpejt se kurdoherë, diaspora edhe nuk është larg dhe bëhet posaçërisht më e rëndësishme", është shprehur Kurti.

Kurti ka përmendur edhe Fondin Sovran Investues. "Me Fondin Sovran do të krijojmë mundësi për diasporën që të blejë aksione në të ardhmen dhe kësisoj ajo të bëhet aksionare e aseteve publike që mundësojnë zhvillimin ekonomik. Por, gjithashtu, do ta kemi edhe Bankën Zhvillimore si mundësi për qasjen në financa me kredi të buta e afatgjata. Bizneset në Kosovë përmendin tri vështirësi kryesore: varfërinë e popullsisë, pra kërkesën e ulët agregate apo fuqinë e vogël blerëse të popullsisë; qasjen e vështirë në financa për shkak të kapitalit të shtrenjtë të bankave komerciale dhe korrupsionin e përhapur në institucionet e sistemit. Me qeverinë tonë, në qeveri ndalet e ndalohet korrupsioni dhe luftohet pa kompromis ai si në institucionet e tjera, gjithashtu edhe në shoqëri mbarë", ka thënë Kurti.

## Ramosaj inspekton punimet në dy projekte infrastrukturore në Deçan

**DEÇAN, 10 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka inspektuar punimet që janë duke u zhvilluar në dy projekte infrastrukturore në këtë komunë. Ramosaj ka bërë me dije se është duke u punuar me kapacitet të plotë për ndërtimin e rrugës e cila të dërgon tek Qendra për Punës Sociale në këtë komunë. Ramosaj ka thënë se kompania e cila është kontraktuar është duke treguar seriozitet në rregullimin e kësaj rruge. "Me tërë kapacitetin po punohet në ndërtimin e rrugës tek Qendra për Punë Sociale. Mirënjohës Kompanisë për seriozitetin e treguar", ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook". Po ashtu, Ramosaj ka thënë se edhe punimet për ndërtimin e objektit të kompanisë komunale "Higjiena" janë duke vazhduar sipas dinamikës së përcaktuar. "Jam i lumtur që më në fund, objekti i ujësjellësit do të ketë funksionin vetëm për ujin e pijes, duke ia larguar 'Higjienën' e cila po bëhet tashmë!", ka shkruar Ramosaj.



# Mbahet takimi i parë i Bordit 'Manifesta 14' në Prishtinë

**PRISHTINË, 10 NËNTOR (ER)** - Është mbajtur takimi i parë i Bordit "Manifesta 14" në Prishtinë. Ky takim është mbajtur në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. "Manifesta 14" synon t'i mbështesë qytetarët e Kosovës për ta shkruar të ardhmen e qytetit të tyre si një metropol me mendje të hapur në zemër të Ballkanit.

Anëtarët e Bordit "Manifesta 14 Prishtina", që përfaqësojnë artistë, profile nga administrata publike dhe e biznesit, synojnë t'i mbështesin qytetarët e Prishtinës në përpjekjen dhe synimin e tyre për ta rikthyer hapësirën publike dhe të rimendojnë konceptin e infrastrukturës kulturore, trashëgimisë dhe kontekstin arkitekturor të Prishtinës.

"Manifesta", Bienalja Evropiane Nomadike, ka shpallur Prishtinën, kryeqytetin e Kosovës, si qytetin e parë nikoqir në Ballkan për edicionin e 14-t të "Manifestës" në 2022. "Që nga themelimi i saj në fillim të viteve 1990, misioni i Manifestës është t'i ekzaminojë ndryshimet topografike kulturore të Evropës. Çdo dy vjet 'Manifesta' shikon botën përmes prizmit të situatës specifike të qytetit të ri pritës. Bordi Mbikëqyrës i 'Manifestës' zgjodhi qytetin e Prishtinës në Kosovë për shkak të rëndësisë gjeografike dhe gjeopolitike të Ballkanit në lidhje me historinë e fundit të Evropës dhe të ardhmen e saj. Në historinë e tij relativisht të shkurtër si kryeqyteti i shtetit më të ri të Evropës, qyteti i Prishtinës ka përjetuar ndryshime të mëdha nga politikat neoliberale të privatizimit të hapësirave të hapura urbane", është theksuar në njoftim e "Manifestës 14".



# Arrestohen dy persona për mbajtje të paautorizuar të armëve




**PEJË, 10 NËNTOR (ER)** - Policia e Kosovës ka arrestuar dy persona të dyshuar për mbajtje të paautorizuar të armëve. "Policia e Kosovës, konkretisht njësiti policor pranë Stacionit Policor në Pejë, më datë 9.11.2019 rreth orës 22:30, në Pejë, përderisa zyrtarët policorë ishin në një pikë te barriera e pylltarisë, kanë ndaluar një veturë me targa vendore. Gjatë kontrollit në veturë është gjetur një armë AK 47. Arma është konfiskuar nga krimteknika, ndërsa dy personat e dyshuar janë arrestuar dhe janë sjellë në Stacionin Policor në Pejë", është thënë në njoftimin e policisë. Të dyshuarve, me urdhër të prokurorit të shtetit, u është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh.

Në shtëpinë e të dyshuarit të parë janë gjetur dhe konfiskuar një pushkë 'M48', kal. 7.92, 16 fishekë, tri gëzhoja të kalibrit të njëjtë, pushkë ajrore 'Flloberg Strong' dhe 20 diabola, 74 copë fishekë të AK 47, dy karikatorë, 17 fishekë të kal. 7.62 mm, një fishek 9x19mm dhe 15 copë fishekë me gaz të kal. 9x19mm. Kurse në shtëpinë e të dyshuarit të dytë janë gjetur dhe konfiskuar 18 fishekë të armës së gjuetisë kal. 12mm.

## Asfaltohen rrugët në Budisalc dhe Stupë të Klinës

**KLINË, 10 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka qëndruar në fshatrat Budisalc dhe Stupë të kësaj komune, me ç'rast ka inspektuar nga afër punimet të cilat janë duke u realizuar për asfaltimin e rrugëve lokale në këto fshatra. Elezaj ka uruar qytetarët për përfundimin e këtyre projekteve, duke theksuar se Komuna e Klinës do të vazhdojë të realizojë projekte të tjera të natyrave të ndryshme me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për të gjithë qytetarët. Kryetari Elezaj gjatë inspektimit të punimeve ka thënë se është shumë e rëndësishme që asfaltimi i rrugëve të bëhet me cilësinë e kërkuar në kontratë, gjë të cilën e ka kërkuar edhe nga kompania kontraktuese.



# E largët është dita kur e takuam për herë të parë Kadri Veselin



Shkruan: Bedri ISLAMI

Më shumë se njëzet e ca vite më parë, në njërin nga takimet në redaksinë e gazetës "Zëri i Kosovës" dhe, si zakonisht, në shoqërinë e njëri-tjetrit me Hashim Thaçin. Ishte një kohë kur ata morën një emër të përbashkët "djemtë", dhe kështu janë njohur që nga ato ditë dhe deri në mbarimin e luftës çlirimtare në Kosovë. I hajthëm, i gjatë, serioz dhe i heshtur më shumë sesa i fjalës, i menduar më shumë sesa ecurak, i sinqertë deri në skajin e qëndrimit, i qartë në atë çfarë donte, ai kishte në vete gjithnjë maturinë që e bënte më të pazakontë se të tjerët. Më vonë, nga miqtë e përbashkët, mësova se ai kishte sjellë në Lëvizjen Popullore të Kosovës, organizatës që ngriti dhe drejtoi UÇK-në, Hashim Thaçin, presidentin e tashëm të Kosovës dhe se, pavarësisht prej rrjedhave të rënda që kishin ndodhur në jetën e lëvizjes klandestine, miqësia e tyre ishte ruajtur dhe së bashku, jo një herë, kishin qenë të rrezikuar. Jo vetëm në ato ditë kur kalonin kufirin me logjistikën e domosdoshme që Adem Jashari e quante buka e UÇK-së, por edhe në çaste të tjera, të cilat, shumë herë, kisha menduar se i takonin një kohe tjetër.

Më i kujdesshëm se të tjerët, më i qartë në pikëvështrimin e tij ndaj ngjarjeve, ai, për shumë kohë, megjithatë, mbeti një figurë enigmatike, e tërhequr, pak e njohur dhe e shfaqur në publik, por që, ndaj të cilit, të gjithë bashkëluftëtarët kishin besimin dhe ndjenjën e duhur të miqësisë. Shumë vite të jetës së tij do të ishin studim dhe ilegalitet, punë të vështira dhe shfaqje të pakta publike, për të ardhur deri në ditën kur, jo befas, lufta do të merrte përmasat e saj të duhura në Kosovë.

Marsi i vitit 1998 dukej i rëndë, i pashpresë dhe mizor, sidomos pas masakrave të para masive të ushtrisë dhe policisë serbe. Në pak ditë kishte pasur mbi 100 të vrarë, të cilët Beogradi zyrtar e jo zyrtar i quante terroristë dhe me të cilët ishin bashkuar edhe shqipfolës, por edhe kancelari të ndryshme perëndimore.

Gjithçka ishte në zgripin e tehun e thikës. Çfarë do të sillte e nesërmja? Një përcaktim, në dukje i përkohshëm, mund të sillte përmbysje të rendit të gjërave. Nëse termi beogradas "terrorist" do të kishte ngelur edhe në kancelaritë perëndimore, lufta në Kosovë do të shuhej ende pa nisur si duhet; një grup djemsh idealistë do të ishin izoluar, struktura do të shpallej e jashtëligjshme, mbështetja do të tërhiqej dhe do të kthehej në izolim. Nëse marsi i vitit 1998, pas vrasjes së Adem Jasharit, do të kishte vetëm gjëmë, vajtim dhe tkurrje, boshllëku i krijuar do të ishte fatal.

Pikërisht në ditët e para të marsit 1998, Kadri Veseli, Hashim Thaçi, Fehmi Lladrovci dhe një grup ilegalësh, pjesë e Lëvizje, mes të cilëve shquhej edhe Xheva Krasniqi-Lladrovci. Ishte momenti më i vështirë i luftës që po vinte, koha kur do të ndahej më dysh e nesërmja: ose do të bëhej si duhej, ose do të mbeste përfundimisht një ëndërr e varë.

Për atë rrugëtim nëpër bjeshkët dhe alpet shqiptare kam folur disa herë me Kadri Veselin. E kemi kujtuar ecjen e atyre ditëve, si ka ndodhur, si vetë ata e kanë përjetuar. I jemi kthyer pikërisht çasteve kur Xheva Krasniqi-Lladrovci u jepte zemër burrave dhe e palodhur ecte në gjurmët e të parëve, por asnjëherë nuk më kishte thënë se asaj kolone, nga e cila do të dilnin drejtues të njohur të luftës, shpesh herë u kishte prirë vetë ai, dhe dihet krejt mirë se, si në çdo luftë, plumbi rreh ndaj të parit.

Për të shkuar tek marsi i vitit 1998 Kadri Veseli, ose, si thoshin ilegalët e tjerë, "Luli", kishte mbi dhjetë vite pjesë e lëvizjes klandestine që synonte të krijonte strukturën e saj të armatosur, UÇK-në. Që kur kishte filluar jetën e studentit e ndoshta edhe më parë. Pas arrestimeve të mëdha në korrik-gushtin e vitit 1993, menjëherë pas Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme të Lëvizjes Popullore të Kosovës, ku ishte marrë vendimi historik për krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kuvend i mbajtur në Prishtinë, në shtëpinë e familjes Brajshori, detyrohet të marrë rrugën drejt Shqipërisë, ku kishte qenë gjithnjë vend-ëndrra e shumë e shumë brezave ilegalësh, të vazhdojë studimet dhe, më pas, si ndodhi me shumë të tjerë të kësaj plejade, të gjendet në mërgim.

Aty e kam njohur. Në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin vend me Hashim Thaçin. Nuk e kam menduar asaj dite se, pas një lufte, njëri do të ishte presidenti i Kosovës dhe tjetri kryetari i Parlamentit. Edhe po të më kishin thënë, do e kisha të vështirë, pasi, lufta që ishte para, do të kishte të rënët e saj dhe askush nuk ishte nisur për të qenë ministër a deputet. As Kadri Veseli.

Më pas e kam takuar shpesh herë, megjithëse jo aq sa do të kishim dashur. Ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, unë isha zgjedhur të drejtoja Lëvizjen Popullore të Kosovës. Rruga ishte e njëjtë, rrugëtimi ishte ndryshe. Kadriu mori përsipër të drejtojë Shërbimin Informativ të Kosovës, një domosdoshmëri e çdo lufte dhe e secilës pasluftë. Ishte një detyrë që domosdo do të kishte të fshehtën e saj, ashtu si do të kishte më pas edhe sulmet e pasluftës. Kishte përballë një strukturë shumë dekadash, me degë të shumta, si shërbimi i sigurimit serb, shërbimi ushtarak serb, degët e tyre në Kosovë, pasi ishte shtrirë prej shumë e shumë viteve; keqkuptime të mëdha me njerëz që e mendonin se lufta ishte e mundshme të bëhej edhe pa këtë shërbim; fillesa takimesh me partnerë ndërkombëtarë, institucione të rëndësishme të shërbimeve të inteligjencës, të fitohej besimi i tyre shumëplanësh, të kishte një përfaqësim si duhej dhe, më pas, bashkërendim real.

Kadri Veseli nuk kishte qenë kurrë njeri i shërbimit inteligjent, por vetëm një njeri i fuqishëm mund ta merrte përsipër këtë. Pas luftës, i monitoruar rreptësisht nga partnerët perëndimorë, ai do e kthejë këtë shërbim në një strukturë të besuar, me lidhje të fuqishme dhe në dobi të Kosovës, krejt ndryshe nga organizata famëkeqe, "Sigurimi i Atdheut", një krijesë e lindur në stanet e shërbimit sekret serb dhe që, pas luftës, ngriti një forcë paraushtarake.

Vetëm fakti që, gjatë gjithë kohës që ishte e pranishme struktura e drejtuar nga ai, asnjë ditë, nuk ngriti dot kokë rryma agresive vehabiste apo salafiste në Kosovë, është më e mjaftueshme për të qenë e dobishme.

Por, unë desha të tregoj për njeriun, me të cilin lidhjet kanë qenë më të fuqishme sa takimet dhe me të cilin mirëkuptimet kanë qenë kurdoherë të pranishme. Përgjithësisht njeri i heshtur, që nga fillesat e aktivitetit të tij politik si pjesë e Lëvizjes Popullore të Kosovës; i fjalës dhe askush nuk mund të thotë se ai e ka shkelur fjalën e tij; i hapur për të gjetur një mendim ndryshe dhe punëtor i madh, ai mbetet një ndër figurat politike më të ndjekura në Kosovë. Megjithë lodhjen që të sjell pushteti në politikë, pra dërmimi nga pushteti, përsëri PDK mbetet njëra nga tri forcat kryesore politike në Kosovë dhe ai vetë, njëri ndër tre liderët më të fuqishëm.

Rrallëherë e kam parë të nxehur apo mospërfillës.

Sidoqoftë unë desha të sjell dy momente nga jeta e tij gjatë luftës:

Ishim në Zvicër kur e telefonuan nga Kosova dhe besoj se ajo bisedë duhet të jetë e regjistruar, sigurisht nga shërbime të tjera. Zvicra kishte asaj kohe prokurore të përgjithshme Karla del Ponte, njërën ndër kundërshtaret më të thekura ndaj luftës çlirimtare në Kosovë, që, për shpirt, do e kishte nxjerrë jashtë ligjit gjithë Ushtrinë Çlirimtare.

Telefonata mes Kadriut dhe tjetrit diku larg po bëhej e ashpër dhe, në një moment, Kadriu i tha se, asnjë qime floku nuk duhet t'i preket njerëzve që nuk kanë lidhje me luftën, qytetarëve të zakonshëm serbë apo të cilësdo kombësi qofshin. Zëri matanë ngulte këmbë, diçka kishte ndodhur, biseda po zgjatej, deri në momentin kur Kadiu i tha shkurt; nëse ndodh diçka, edhe më e vogla qoftë, do të përgjigjesh. Mbaje mend, shtoi në fund!

Në muajt e parë të luftës, Kadri Veseli me një grup shokësh, pikërisht në Rahovec, ranë në një pritë serbe. Prita është gjithnjë e papritur. Luftëtarët morën qëndrimin e tyre dhe iu përgjigjën policisë serbe. Për disa minuta kishte krisma pafund armësh dhe pastaj gjithçka u qetësua.

Nuk kishte të dëmtuar. Aty afër ishte një dyqan i vogël ushqimor, i bërë gjithë vrima nga plumbat e një dite tjetër. Kadriu u fut brenda dhe bleu disa çokollata. Bashkëushëtari i tij e pyeti se çfarë i duhen, pikërisht tani, kur sapo shpëtuan nga prita.

Kadriu iu përgjigj: - E njeh nanën e Lahi Brahimit? E kemi lodhë nënën, tash e parë në shtëpinë e saj, shtro e mbulo, e kurrë një herë nuk i çuam një diçka të vogël. Është nënë dhe e bën me shpirt, por mendova një herë t'i çojmë diçka të ëmbël... dhe qeshi, sikur të kishte plotësuar një dëshirë të hershme.

Kadri Veseli, kryetari i deritashëm i Parlamentit të Kosovës, është ftuar nga Dhomat Speciale, të njohura si Gjykata Speciale, një strukturë e ngritur me miratimin e parlamentit, ku është drejtues vetë ai.

Kam menduar shpesh herë për këtë, në të gjithë këto ditë, që kur u bë e njohur thirrja në Gjykatën Speciale.

A është e mundur? - i thashë vetes dhe kjo, pasi e kam njohur nga afër qëndrimin e tij ndaj luftës dhe njerëzve.

Në 20 vite pasluftë u bë një fushatë e egër ndaj luftës çlirimtare dhe bartësve të saj; luftë e burimuar nga jashtë Kosovës dhe e ardhur në Kosovë me dëshpërimin e atyre që humbën luftën. Qofshin në Serbi, qofshin në Kosovë, qofshin në Shqipëri e në disa vende që e kanë mendjen tek aleancat e vjetra politike dhe financiare.

Kadri Veseli, jam i bindur, as nuk e ka drojën e kësaj thirrje dhe do të rivijë po aq i denjë për Kosovën se atë ditë që do të niset. Është një histori që përsëritet me fituesit e luftës.

Në fund të fundit, ata mbeten gjithsesi fitues!



## Ministri gjerman kritikon Macronin për deklaratat lidhur me NATO-n



BERLIN, 10 NËNTOR - Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas sërish ka ritheksuar qëndrimin kundër të shtetit të tij ndaj kritikave që ka bërë Franca për NATO-n, duke paralajmëruar se "as Gjermania e as Evropa, nuk do të jenë në gjendje që ta mbrojnë veten në mënyrë efektive", pa ndihmën e Shteteve të Bashkuara.
Këto komente vijnë në kohën kur Uashingtoni po bën presion që shtetet anëtare të NATO-s të paguajnë më shumë për mbrojtje.
Presidenti i Francës, Emmanuel Macron gjatë kësaj jave deklaroi se "truri i NATO-s ka vdekur", duke sugjeruar që Evropa duhet të marrë në duart e saj çështjen e sigurisë dhe nuk duhet të varet nga Shtetet e Bashkuara për t'i mbrojtur aleatët e saj.
"Do të ishte gabim nëse e minojmë NATO-n", tha Maas për Der Spiegel.
Më herët, edhe kancelarja gjermane Angela Merkel ka kritikuar Macronin për deklaratën e tij për NATO-n.
Ministri gjerman, Maas po ashtu pranoi se evropianët duhet t'i ndërtojnë kapacitetet e tyre mbrojtëse.

# Gjermania shënoi 30-vjetorin e rënies së Murit të Berlinit

Duke folur në një shërbesë në një kapelë të vogël pranë vendit ku qëndronte dikur Muri, kancelarja gjermane Angela Merkel përkujtoi ata që u vranë ose u burgosën në përpjekjet për të ikur nga Lindja në Gjermaninë Perëndimore dhe këmbënguli se lufta për lirinë në mbarë botën nuk ka mbaruar



BERLIN, 10 NËNTOR - Ndër ceremonitë e zhvilluara me rastin e 30-vjetorit të rënies së murit të Berlinit, udhëheqësit vendosën trëndafila në një nga pjesët e fundit të mbetura nga barriera e frikshme që ndante qytetin.
Kancelarja gjermane Angela Merkel kujtoi të vrarët dhe të burgosurit dhe u shpreh se lufta për lirinë në mbarë botën nuk ka mbaruar ende.
Drejtuesit nga Gjermania, Polonia, Hungaria, Sllovakia dhe Republika Çeke morën pjesë në një ceremoni në Bernauer Strasse - ku ka mbetur një nga pjesët e fundit të Murit të Berlinit - përpara se të vendosnin trëndafila në barrierën e frikshme që ndau qytetin për 28 vjet, ka njoftuar rfe.
Udhëheqësit qëndruan për homazhe pranë një memoriali kushtuar protestuesve në Gjermaninë Lindore dhe vendet fqinje të Paktit të Varshavës që dolën në rrugë duke kërkuar liri dhe demokraci, dhe nga udhëheqësi i atëhershëm sovjetik Mikhail Gorbachev politikën e reformave.
Duke folur në një shërbesë në një kapelë të vogël pranë vendit ku qëndronte dikur Muri, Kancelarja gjermane Angela Merkel përkujtoi ata që u vranë ose u burgosën në përpjekjet për të ikur nga Lindja në Gjermaninë Perëndimore dhe këmbënguli se lufta për lirinë në mbarë botën nuk ka mbaruar.
Kancelarja Merkel gjithashtu rikujtoi se në këtë ditë u zhvillua edhe sulmi kundër hebrenjve në vitin 1938 që paralajmëroi holokaustin nazist.
"9 nëntori, data që reflekton momente të tmerrshme por edhe të gëzueshme të historisë sonë, na bën të vetëdijshëm se duhet të përballemi me vendosmëri me urrejtjen, racizmin dhe anti-semitizmin. Na kujton të bëjmë gjithçka që mundemi për të mbrojtur lirinë dhe demokracinë, dinjitetin njerëzor dhe shtetin ligjor", tha kancelarja gjermane Angela Merkel.
Vetëm një ditë më parë, Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo, përuroi në Berlin një statujë të ish-presidentit amerikan Ronald Reagan, në vendndodhjen ku ai pati mbajtur fjalimin historik ku i bënte thirrje Bashkimit Sovjetik të hiqte Murin e Berlinit.
"Për shkak të udhëheqjes së tij kurajoze dhe përkushtimit ndaj lirisë, ai denoncoi me kurajë kërcënimin më të madh ndaj lirisë - Perandorinë Sovjetike, perandorinë e së keqes. Ai e dinte se në vend që t'i mbronin të drejtat e shtetasve të tyre, ata i keqtrajtonin brutalisht dhe i ekzekutonin. Ai e dinte se ata mbikëqyrnin edhe lakenjtë komunistë në vende si Gjermania Lindore, të cilët i bënë të njëjtën gjë popullit të tyre", tha Sekretari Pompeo gjatë ceremonisë për inaugurimin e statujës së ish-presidentit Reagan.
Instalacione, koncerte dhe debate publike janë mbajtur në të gjithë qytetin dhe në pjesë të tjera të Gjermanisë ku u shënua rënia e Murit, duke përfshirë një koncert në portën ikonë të Brandenburgut të Berlinit.

# Trumpi dhe Stoltenbergu takohen më 14 nëntor



UASHINGTON, 10 NËNTOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump do të takohet me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg këtë javë, për të diskutuar për shpenzimet ushtarake.
Ky takim vjen në kohën kur presidenti amerikan po vazhdon përpjekjet e tij që t'i shtyjë vendet anëtare të Aleancës që të paguajnë më shumë për mbrojtjen e tyre.
Shtëpia e Bardhë njoftoi se të dy liderët do të takohen më 14 nëntor për të biseduar për "progresin e aleatëve të NATO-s në rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes që të sigurohet ndarje e barabartë e barrës" së shpenzimeve.
Takimi Trump-Stoltenberg vjen para mbajtjes së samitit të NATO-s që është paraparë të mbahet më 3 dhe 4 dhjetor në Londër.
Ky takim vjen një javë pasi presidenti i Francës, Emmauel Macron, paralajmëroi shtetet evropiane se NATO-ja po vdes për shkak se Uashingtoni është i paparashikueshëm nën drejtimin e Trumpit, por ky qëndrim menjëherë u kundërshtua nga Gjermania, por u lavdërua nga Rusia.
Gjatë qëndrimit në Uashington, Stoltenbergu do të takohet edhe me Sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo dhe me anëtarë të Kongresit. Ai, po ashtu, do të marrë pjesë në takimin e koalicionit botëror kundër grupit militant, Shteti Islamik (IS).

## Spanjollët votuan në zgjedhjet parlamentare



MADRID, 10 NËNTOR - Spanjollët kanë votuar të dielën në zgjedhjet e katërta të vendit brenda katër vjetësh.
Ashtu si herën e fundit Partia Socialiste e kryeministrit Pedro Sanchez pritet të jetë fituesja kryesore.
"Votimi i së dielës do të vendosë dhe zgjedh të ardhmen e Spanjës. Gjëja më e rëndësishme që unë mendoj, si politikan dhe qytetar, është t'i nxisë spanjollët të votojnë dhe, së dyti, të forcojnë demokracinë e Spanjës në një ditë si sot", tha kryeministri në detyrë Pedro Sanchez.
Fushata para zgjedhjeve të së dielës u përqendrua kryesisht në lëvizjen për shkëputjen e Katalonjës dhe rritjen e shqetësimeve për Vox-in, një parti e ekstremit të djathtë.
"Ne do t'i shtrijmë dorën Partisë Socialiste. Besojmë se duke kombinuar trimërinë e Unidas Podemos me përvojën e Partisë Socialiste mund të shndërrojmë vendin tonë në një referencë për politikat sociale. Do t'i lëmë pas debatet. Spanja mund të shndërrohet në një shembull të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave sociale. Do t'i lëmë debatet pas dhe të fillojmë të punojmë së bashku", tha Pablo Iglesias, udhëheqës i partisë Unidas Podemos.
Në zgjedhjet e mëparshme, partia e liderit spanjoll nuk arriti të fitojë vota të mjaftueshme për të formuar një qeveri të qëndrueshme. Partneri i natyrshëm i Partisë Socialiste në pushtet do të ishte e majta Unidas Podemos.




# AUTOSHKOLLA
# "RITMO – L"



**Auto Shkolla**
**"RITMO - L"**
**Prishtinë**

## Eksperienca jonë - përfitimi i juaj.

**Ju mirëpret:**
**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**
**Tel / kontakt:**
**044 248 173**
**044 200 604**
**044 375 333**

E rrallë

## Presidenti 'i çmendur' shpenzon 46 mijë dollarë për një gaforre



Një gaforre është shitur për 46 mijë dollarë në Japoni. Krijesa e detit kishte këtë vlerë të lartë pasi ishte 14.6 metra e gjatë dhe peshonte 1.2 kilogram. Gaforrja e borës u ble nga Tetsuji Hamashita, presidenti i një kompanie prodhimesh deti. Ai bëri këtë blerje me qëllim që t'ua shërbejë të pasurve në restorantet më luksoze të Tokios. "E di që çmimi është tej mase i lartë, por kështu e do zakoni. Megjithatë, jam i sigurt se gaforrja e justifikon çmimin", ka njoftuar Hamashita për CNN.

FOTO E DITES




Në Bagdad shihen disa persona duke protestuar kundër qeverisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Zbulohet peshku me fytyrë njeriu



Një peshk me "fytyrë-njeriu" është filmuar nga një prej banorëve të zonës në një liqen në provincën Yunnan të Kinës. Peshku me ngjyrë ari afrohet pranë bregut, nxjerr kokën dhe një pjesë të trupit të tij mbi sipërfaqen e ujit. Besohet se peshku i rrallë është pasardhës hibrid i dy specieve të ndryshme peshqish të llojit krap; krapi i zakonshëm dhe krapi prej lëkure, i njohur ndryshe si peshku 'mandarinë'.

BARSOLETA E DITËS



- Doktor, vuaj nga amnezia.
- Që kur?
- Që kur, çfarë?!

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

**ABOMINABLE 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton







Çdo ditë në ora 16:00

**TOY STORY 4 / 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley

Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

**MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D**

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning







Çdo ditë në ora 22:00

**ZOMBIELAND DOUBLE TAP**

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Ju mund të ndiheni të nxitur për ta vendosur të dashurin tuaj në piedestal sot. Dëshironi ta shihni atë si bashkëshortin/en e përsosur për ju. Jeni të gatshëm të shkoni shumë larg për t'i sjellë kënaqësi këtij personi.



**DEMI**
Romanca nuk po ju shkon mirë, mund të keni pikëpyetje. Ngjarjet që do të ndodhin sot do ta bëjnë të vështirë injorimin e kësaj çështjeje. Komunikimi është çelësi që ju ndihmon për të renditur ndjenjat e lidhura me këtë çështje.



**BINJAKËT**
Dashuria dhe romanca janë kartat me të cilat do t'ju duhet të luani sot. Luaj dorën që të është dhënë dhe largohu nga tryeza fitimtar. Një transformim mund të ndodhë më çështjet e zemrës. Në asnjë mënyrë nuk duhet të komprometoni veten.



**GAFORRJA**
Çështjet me romancën zënë një pjesë të madhe të ditës së sotme. Peshorja do të anojë në anën tuaj për këtë çështje. Ju jeni të aftë për t'i mbajtur gjërat e thjeshta dhe argëtuese. Zbulimin e emocioneve dhe pasioneve tuaja lëreni për një ditë tjetër.



**LUANI**
Çështjet e zemrës janë në favorin tuaj sot. Ju duhet të përgatiteni për një ditë të mbushur me aktivitete sociale dhe biseda të vlefshme. Shpirti juaj kreativ do të jetë në nivele të larta. Ju nuk gaboni në zgjedhjen e një artikulli në dyqane rrobash.



**VIRGJERESHA**
Ditën e sotme do të fokusoheni tek romanca , por mund ta keni të vështirë të gjeni një mënyrë për të shprehur ndjenjat tuaja. Tek kjo çështje ndikon fuqia dhe sigurisht nuk mungon pasioni.



**PESHORJA**
Kur bëhet fjalë për çështje që kanë të bëjnë me dashurinë, mos u ndalni. Gjërat janë në favorin tuaj dhe nuk duhet të hezitoni që të veproni me forcë dhe besim. Tregojuni të tjerëve sa seriozë jeni, situata është në favorin tuaj.



**AKREPI**
Mund ta keni të vështirë ta përqendroni energjinë tuaj diku sot. Çështje që kanë të bëjnë me romanticitetin dhe dashurinë mund të lindin dhe ju do të ndjeni dëshirën për të filluar diçka në lidhje me këtë çështje. Mund të jeni të pavendosur se cilën rrugë duhet të ndiqni.



**SHIGJETARI**
Ju mund të dëshironi të ecni përpara me një projekt, ndërsa një partner i afërt kërkon që të uleni dhe t'i diskutoni gjërat bashkë. Do të ndizen gjakrat midis jush, prandaj duhet të jeni gati për të bërë një kompromis.



**BRICJAPI**
Dashuria do të jetë në mendjen tuaj sot, kështu që jepini zemrës suaj vëmendje të plotë. Keni probleme komunikimi me të dashurin tuaj, kështu që përpiquni të bëheni të sjellshëm. Nga çfarëdo drejtimi që të lëvizni, do të përplaseni.



**UJORI**
Çështjet që kanë të bëjnë me dashurinë do të jenë në favorin tuaj sot. Është një forcë që ju shtyn të ndërmerrni veprime. Kujdesuni për këtë energji dhe qëndroni të hapur ndaj shoqërisë. Bisedat me miqtë mund të jenë të dobishme tani.



**PESHQIT**
Sot do të përballeni me tension në lidhjen tuaj në çift. Ju dëshironi të filloni një marrëdhënie që është e rëndësishme për ju, dhe duket se gjërat po shkojnë sipas planit. Në vend që të anashkaloni rrugën tuaj, bëni një qasje më të drejtpërdrejtë.

# Jimmy Fallon surprizon tre studentë me pagesën e shkollimit



Jimmy Fallon mahniti tre studentë të Universitetit të Teksasit në Austin me një surprizë të madhe. Jimmy Fallon ishte duke filmuar në Austin në Sallën e Koncerteve në Bass kur ai thirri Alma Zamora, Elizabeth Yun dhe Fitzgerald Alan në skenë. Fallon i bëri ata të prezantoheshin para audiencës dhe më pas vazhdoi t'u tregonte atyre që "Samsung" i kishte zgjedhur ata për të fituar smartphone të rinj dhe një pako me veshje të lezetshme.



# Miley Cyrus i nënshtrohet një operacioni

Miley Cyrus i është nënshtruar një operacioni të kordonit vokal pasi u shtrua në spital muajin e kaluar, ka njoftuar "People". Mjekët zbuluan se kishte probleme me kordat e zërit gjatë qëndrimit në spital, duke e njoftuar më pas këngëtaren se ajo do të duhej të operohej deri në fund të vitit dhe i duhet pushim për t'u shëruar. Një burim ka thënë se ajo është mirë dhe do të kthehet më mirë se kurrë në fillim të vitit të ardhshëm.

# Amber Heard kërkon që Johnny Depp t'i nënshtrohet një vlerësimi të shëndetit mendor





Amber Heard i ka kërkuar zyrtarisht ish-burrit, Johnny Depp, që t'i nënshtrohet një vlerësimi të shëndetit mendor, sipas dokumenteve të reja gjyqësore. Dokumentet juridike të marra nga The Blast tregojnë se gruaja e tretë më e bukur në botë po kërkon që një profesionist i shëndetit mendor të lejohet të drejtojë një vlerësim mendor për aktorin e "Pirates of the Karaibbean". Heard beson se përdorimi i supozuar i drogës dhe alkoolit kontribuuan në abuzimin e tij të supozuar.

# Kanye West dëshiron ta ndryshojë ligjërisht emrin në "Miliarder"



Artisti dhe stilisti Kanye West ka hedhur një ide të re për emrin e tij dhe sinqerisht është e vështirë ta dallosh nëse ai bën shaka. Në një paraqitje të papritur në Festivalin "Fast Company Innovation 2019", West sugjeroi që ai mund ta ndryshojë ligjërisht emrin e tij në "Christian Genius Billionaire Kanye West" për një periudhë. "Kur njerëzit thonë se është e rastësishme ta quajmë veten miliarder, unë mund të ndryshoj me ligj emrin tim në Miliarderi Christian Genius Kanye West për një vit derisa të kuptosh saktësisht se çfarë është", i tha ai shkrimtarit të vjetër të kompanisë "Fast Company", Mark Wilson.

# Cvijiqi: Peshterasit janë të gjatë, vitalë, elastikë, syshqiponjë, të sojit të bukur...!

Ndër studiuesit më të dalluar në shkencën sllave, Jovan Cvijiq, ka ardhur në përfundim se popullsia shqiptare është me origjinë ilire dhe është një ndër popujt indoevropianë më të vjetër e autokton në Ballkan. Në konstatim të këtillë kanë ardhur edhe autorë të tjerë sllavë, të cilët do t'i përmendim më vonë.

Megjithatë, konstatimet e këtilla nuk kanë qenë në interes të politikës sllave, posaçërisht të asaj serbomadhe. Borgjezia serbe e kohës së Cvijiqit, ka udhëhequr një politikë kryekëput ekspansioniste-grabitqare. Qëllimi i saj, duke u dhënë rëndësi faktorëve natyrorë, ka qenë që t'i okupojë ato vende, të cilat mundësojnë dalje në det dhe që kanë rëndësi gjeostrategjike. Për të arritur këtë qëllim është dashur në fillim vendi të çlirohet nga okupuesi osman, e pastaj sa më tepër që është e mundur të marrin vend nga trojet e popujve të tjerë. Në mënyrë që të arrihej objektivi i caktuar i qeverisë serbe, më vonë edhe asaj jugosllave, para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, duhej t'i vinin në ndihmë edhe punëtorët e shkencës, në krye me Akademinë e Shkencave.

Pikërisht, për këtë qëllim, Cvijiqi me mbështetësit e tij të kohës dhe pasuesit e mëvonshëm, duke harruar atë që kanë konstatuar më parë, filluan të plasojnë teza të reja për çështjen shqiptare të paqëndrueshme në fushën shkencore, që u kanë shërbyer interesave të politikës shtetërore grabitqare. Këto teza të Cvijiqit gjejnë mbështetje edhe në kohët e mëvonshme nga autorët sllavë. Shkolla gjeografike e drejtimit antropogjeografik, të cilën e themeloi Cvijiqi, dallohej me dy cilësi: e para mbështetet në sqarimet parciale dhe në shtrembërimin e fakteve, që flasin për autoktoninë e shqiptarëve, dhe, e dyta, ka pasur qëllime kryekëput politike.

Në analizat shkencore që u ka bërë akademiku Hivzi Islami veprave të Cvijiqit, vjen në përfundime mjaft korrekte. Në interpretimet e informacioneve dhe të dhënave nga terreni, Cvijiqi "ishte joobjektiv, spekulant e konstruktues i konkluzioneve, shovinist e hegjemon".

Në vijim po japim pjesë të shkrimeve të autorit në fjalë, të cilat kanë të bëjnë me mjedisin, gjegjësisht, Sanxhakun, ku takohen popullsia sllave dhe shqiptare. Në aspektin gjeografik, fiset më të forta etnografike të Gadishullit Ballkanik, janë: banorët e Kodrave të Malit të Zi, pjesët e Hercegovinës, Peshterit dhe viset e Shqipërisë veriore. Banorët e këtyre trevave i kanë ruajtur formën e vjetër të vëllazërisë fisnore, gjinive-fiseve dhe organizimin e tyre. Këta kryesisht janë shumë të gjatë, vitalë, elastikë dhe kurrsesi të trashë, fytyrë me plot shprehje, syshqiponjë të sojit të bukur/racës në Gadishullin Ballkanik – të gjithë, edhe shqiptarët myslimanë siç i quan ai "arbanasët muhamedanë".

Në jetën e përditshme janë shumë të përmbajtur, në të shumtën e rasteve nuk konsumojnë asnjë lloj pije alkoolike, ndërsa duhan dhe kafe shumë rrallë. Pothuajse nuk ka individ me të meta fizike e të degjeneruar, siç thotë ai. Ata e kanë ruajtur moralin e fortë malor, shpesh me veçori bujare, me ndjenja të thella për bashkësinë familjare dhe flijimin, e cila nuk mungon as pranë viktimave më të çmuara. Nga këto veçori rrjedhin veçori të shumta etnografike dhe antropogjeografike. Këto veçori janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kulturën dhe zakonet e popujve bizantinë dhe cincarë (arumunët). Për arbanasët (shqiptarët) toskë në jug, thotë se kanë shumë tipare bizantine dhe cincare.

Në pjesët veri-perëndimore të viseve të Serbisë blegtorët i quajnë "arnautin", por ky është emri që nuk tregon njeriun e pasur me bagëti, por tani njerëzit e këtyre rajoneve, gjegjësisht, banorët e Sjenicës dhe Peshterasit i quajnë arnautë (shqiptarë). Ndërsa, banorët e trevës së Novi Pazarit dhe të Senicës, të cilët në masë të madhe i kanë banuar trevat e Stari Vllahut dhe Shumadinë, thuhet se kanë ardhur nga Arnautllaku (Shqipëria). Shumë fshatra në Shumadinë e ulët quhen treva të arnautëve (shqiptarëve), siç janë: Rogaci, Babana etj. Mandej edhe uzhiqasët të cilët kanë zbritur për të jetuar në Jadar dhe Maçvë. Njerëzit e atyre vendeve i kanë quajtur arnautë (shqiptarë). Edhe banorët e Kragujevcit, të cilët kanë ardhur nga trevat e Rashkës (Sanxhakut) i kanë quajtur arnautë (shqiptarë).

Në Serbinë lindore nuk është emri i pazakontë arnautë, dhe është i lidhur me imigrantët nga rrethina e Rashkës (Sanxhakut), ku janë në numër të madh. Kështu, lagjet e fshatrave i kanë quajtur lagje arnaute, ndërsa lumi që kalon nëpër qytetin e vogël të Bolevacit quhet Arnaut, siç kemi rastin edhe me shumë vorbulla. Shumica e të ardhurve në Serbi , nëpër qyteza ku janë përqendruar cincarët, rryma më e madhe për nga numri i të ardhurve janë nga Hercegovina, kodrat e Malit të Zi, trevës së Novi Pazarit, Bosnjës, por ka edhe arbanasë (shqiptarë).

Në Sanxhakun e Novi Pazarit në mesin e të ardhurve, në trevën e Sanxhakut ka Vasojeviq dhe një numër i madh i fisit Kuç, sidomos përgjatë luginës së lumit Lim. Cvijiqi në veprën e tij përveç tjerash shkruan: "Procese të rëndësishme etnografike kanë ndodhur në ato vise ku janë takuar popujt sllavë dhe ai shqiptar në Mal të Zi. Arbanasët janë serbizuar edhe në Mal të Zi. Të origjinës së tillë janë një pjesë e fisit Kuç dhe Piper, përveç asaj Vasojeviqët janë zgjeruar në kurriz të klimentëve (fisit Kelmend). Të njohura janë traditat gojore të origjinës së përbashkët të Vasojeviqëve, Piperëve dhe Ozriniqëve me Hotin dhe Krasniqin dhe afërsitë në mes tyre. Për fiset në Mal të Zi, thuhet se i kanë asimiluar popullsinë e vjetër në Bukumir, Kriçke dhe Potarje, dhe në mesin e tyre edhe fiset fqinje shqiptare". */Telegrafi/*



# "Korrieri" i filmit shqiptar



Për vite me radhë ai ishte, me shumë gjasë, korrieri më i rëndësishëm kulturor në Tiranë. Ishte 14 vjeç kur mori biçikletën, bobinën e filmit në çantë dhe nisi të përshkonte rrugën nga Kinema "17 Nëntori" te "Partizani". I jepte shpejt pedaleve – duhet ta çonte bobinën në kohë, publiku priste…

I pari që iu qas kinemasë ishte i vëllai, pastaj ai, dhe me kalimin e vite e ia pasoi zanatin edhe të bijve. Theodhor Ziu është një nga kinomekanikët e parë të kryeqytetit, që ende vazhdon të shfaqë filma.

"Im vëlla punonte në kinema dhe kur mbarova shtatëvjeçaren; iu qepa atij nga pas, që edhe unë të punoja si ai. Isha 14 vjeç dhe më paguanin me 240 lekë rrogë. Babai s'la vend pa kërkuar për të mësuar se ku punoja dhe ku i gjeja ato para. Pasi bisedoi me drejtorin e Kinemave, Mustafa Kuzmi, ky i tha që kur të mbushja 16 vjeç do hyja në punë si kinomekanik. Fillimisht transportoja filmat nga Kinema 'Partizani' te '17 Nëntori', sepse ishte vetëm një kopje për të dyja kinematë", tregon ai për "Sekrete mjeshtërie".

### Ishte fëmijë, profesioni i pëlqente, por dëshironte të vazhdonte edhe shkollën.

"Fillonte shfaqja në 09:30 te Kinema '17 Nëntori', në 10:30 te 'Partizani' e kështu me radhë deri në orën 21:00, që ishte orari i fundit. Ishte një punë që e bëja me kënaqësi. Përpiqesha të mësoja nga ustallarët Sulejman Qerimi dhe Hysni Vogli, që sot nuk jetojnë më. Mësoja si vihej filmi, si hiqej, nga dilte zëri, si funksiononte filmi, ku ishte kolona zanore… Kur u bëra 16 vjeç më kërkuan të bëhesha ndihmëskinomekanik. Por, ndërkohë unë doja të vazhdoja edhe shkollën, sepse s'mund të mjaftohesha me tetëvjeçaren, por së pari më kërkuan të bëja një provë në punë, në të cilën dola shumë mirë", thotë Theodhor Ziu, teksa pret të shkojë ora, që të shfaqë filmin në Kinema 'Agimi'".

### Rruga nga njëra kinema tek tjetra zgjaste 30-40 minuta. Përgjegjësia ishte e madhe…

"Mësova biçikletën, por nuk kishte as shumë makina, rrugët ishin të lira, por ama djersët më shkonin çurg. E fusja filmin në një çantë meshine të lidhur, e vija pas biçikletës dhe vrap nga Kinema '17 Nëntori' te 'Partizani'. Çdo gjë duhej të bëhej me shpejtësi, sepse mbaronte bobina e parë, duhej vënë e dyta, ndërroheshin nga një aparat në tjetrin, ndërsa jepej e dyta duhej çuar e treta. Lodhja ishte e madhe", tregon ai. Për pesë vjet punoi si transportues dhe në 1969 mori dëshminë si kinomekanik, për aparaturat e vogla. Iu desh të shkëputej dy vjet, gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak (1970-1972), por sapo u kthye, e thirrën sërish në punë, por këtë herë duhet të çonte filmat në fshat. Shkonte fshat më fshat: Zall-Bastar, Shupal e me radhë, deri në Malin me Gropa e Shëngjergj. Për pesë vjet çoi filmin nëpër fshatrat e Tiranës.

"Çdo fshat kishte Pallat Kulture, mblidheshin të gjithë dhe u shfaqja filmin. Kam çuar çdo film shqiptar. Shfaqja edhe të huaj, por sidomos në fshat pëlqenin më shumë shqiptarët".

Sa më shumë kalonin vitet, aq më shumë e donte kinemanë dhe filmin. Ishte momenti që edhe në karrierë të ecte përpara. Pasi dha provimin për aparaturat e mëdha mori patentën që ka edhe sot.

### Incidentet për shkak të transportit ishin të pakta, por kishte edhe raste si zjarri i rënë në Kinema "Brigada".

"Shfaqeshin edhe filma të djegshëm. Për shkak të nxehtësisë së karboneve ata lëshonin tym dhe duhej fikur menjëherë, pasi merrnin flakë. Ne kishim batanije dhe fikse në dispozicion, për raste të ngjashme", thotë ai.

Sigurisht, nuk mungonin vështirësitë, por ai flet me nostalgji për vitet kur njerëzit e donin kinemanë, ndërsa tani kanë mbetur shumë pak syresh.

"Njerëzit prisnin radhë, prisnin biletë, mbanin rregull, po kishte raste edhe që thyheshin dyert, si te 'Zonja e panjohur' apo 'Fatma', 'Aventurat e Uliksit' me Bekim Fehmiun, 'Korrupsion në Pallatin e Drejtësisë' etj. Kur kishte filma të mirë, interesi ishte shumë i madh, edhe pse filmat ishin të prerë".

Ishin vite censure dhe shpesh herë filmat priteshin ose bllokoheshin. Vinte urdhri "nga lart", siç thotë Dhori dhe të gjitha ato pjesë që binin ndesh me "vijën e Partisë", zhdukeshin.

"Kemi pasur bllokime. Dy ditë pasi doli filmi 'Një jetë', na thanë ta ndërprisnim shfaqjen e tij. Në vend të tij më dhanë një film kinez, 'Pishat e blerta'. Na ndodhte që 'të mëdhenjtë' të jepnin urdhër për bllokim dhe filmi hiqej nga qarkullimi. Vinte urdhri për prerje, por unë ua kërkoja me shkrim, me numra, sepse çdo dialog kishte një numër. Ndodhte që ose i ndërrohej titulli filmit, ose pritej momenti ku kishte ndonjë skenë dashurie".

Asgjë nuk shfaqej pa u kontrolluar më parë nga organet e censurës, madje vetë udhëheqja i shihte e para. Të gjithë kineastët shqiptarë tregojnë ankthin e pritjes dhe kërkonin të shquanin fytyrën e kinomekanikut, që kishte shfaqur filmin në Bllok. Aty "lexohej" e ardhmja e filmave të tyre.

"Udhëheqja i shihte të gjithë filmat. Unë kam shkuar vetëm dy herë atje, një herë në Bllok dhe një herë në Komitetin Qendror. Një herë për shfaqjen e filmit për Hysni Kapon, 'Besniku i Partisë'. Vetëm 10 minuta film pa Enver Hoxha. Isha 27 vjeç. 'Mirë mo, mirë', tha Enver Hoxha dhe filmi kaloi".

Gjatë viteve 1978-85 punoi në Kinemanë e Laprakës, ku i kanë kërkuar të punojë sërish, kur ajo të merret në dorëzim pas rikonstruksionit. Në vitin 1986 u bë përgjegjës në Kinema "Partizanin", por në vitin 1989 kur aty pritej të mbahej një mbledhja ballkanike, kinemaja u dogj. Brenda natës ajo u zhduk dhe pasojat do të binin edhe mbi Theodhor Ziun. Edhe pse ai nuk u shpall asnjëherë fajtor, do të dënohej me gjashtë muaj heqje lirie, gjatë së cilës do të riparonte televizorët e burgjeve.

Emri i tij nuk figuron në listat e të dënuarve e si rrjedhojë as do të shpërblehej për muajt e heqjes së lirisë. Por, pavarësisht se ka kaluar shumë në jetë, ai e vlerëson periudhën kur spektatori priste në radhë për të parë një film. Është një zanat i vështirë, por ai thotë se ka dashur t'ia trashëgojë të tre djemve të tij.

"Duhet që në radhë të parë të njohësh filmin", thotë ai.

Po ashtu siç ai u transmetoi zanatin, ata i mësuan teknologjinë dhe sot, kinomekaniku që bariste me biçikletë nga njëra kinema në tjetrën, për të çuar bobinat e filmit, sot punon me teknologjitë më të fundit digjitale. /"Sekrete Mjeshtëri" – Ministria e Kulturës e Shqipërisë/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi Servisim Porosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Gabojnë Gjilani dhe Ballkani, përfiton Prishtina

Në katër ndeshjet e zhvilluara të javës së 15-të janë regjistruar tri barazime dhe një fitore. Skuadrat kryesuese nuk kanë mundur të marrin më shumë se nga një pikë, kurse sot (e hënë) zhvillohen edhe dy ndeshje në mes të katër skuadrave të fundit në renditjen tabelore

EPOKA E RE Veton ZYMBERI




PRISHTINË, 10 NËNTOR - FC Prishtina ka shkëlqyer në derbin ndaj Llapit duke fituar me rezultat 1-4 dhe në këtë mënyrë i është afruar pozitës së parë në vetëm katër pikë. Në ndeshjen e zhvilluar të shtunën në stadiumin "Zahir Pajaziti" ka shkëlqyer skuadra e Prishtinës, e cila iu hakmor Llapit për humbjen në kryeqytet.

Në minutën e 25-të Endrit Krasniqi e hapi serinë e golave për Prishtinën, kurse shtatë minuta më vonë realizoi edhe mbrojtësi Ahmet Haliti për 2-0. Në fillim të pjesës së dytë Ahmed Januzi e shtoi epërsinë e mysafirëve në 0-3, kurse golin e fundit për këtë skuadër e realizoi kapiteni Armend Thaqi (71'). Ndërsa golin e vetëm për llapjanët e shënoi Kastriot Selmani (75').

Prishtina është e katërta në tabelë me 27 pikë, kurse Llapi është një pozitë më poshtë me 24 pikë.

Në Drenas, Feronikeli dhe Drita ndanë pikët të shtunën, pasi luajtën baras 0-0. Befasi shkaktoi Drenica që arriti t'ia marrë skuadrës lidere, Gjilanit, një pikë (1-1). Gjilanasit kaluan të parët në epërsi në minutën e 39 me golin e Fiton Hajdarit nga penalltia, por mysafirët nga Skenderaj arritën ta barazojnë rezultatin me golin e shënuar nga Harmon në minutën e 71-të. Pavarësisht prej këtij barazimi, Gjilani vazhdon të jetë lider i elitës me 31 pikë, ndërkohë Drenica është e shtata me dhjetë pikë më pak. Fitore nuk arriti as skuadra e Ismet Munishit në përballje me Trepçën '89 në Mitrovicë, pasi rezultati final ishte 0-0. Në pjesën e parë Manaj i vendësve lëshoi dy raste shënimi, kurse në anën tjetër Topalli i mysafirëve dështoi të realizojë i vetëm përballë portierit vendës. Skuadrat u munduan ta gjejnë rrugën e golit edhe në pjesën e dytë, por pa sukses dhe ndeshja përfundoi 0-0.

Sot (e hënë) zhvillohen dy ndeshjet e fundit për javën e pesëmbëdhjetë në elitë, derisa takohen katër skuadrat që renditen të fundit në tabelë Vushtrria - Ferizaj dhe Dukagjini - Flamurtari.

## IPKO SUPERLIGA

| | |
|---|---|
| Trepça '89 - Ballkani | 0-0 |
| Gjilani - Drenica | 1-1 |
| Llapi - Prishtina | 1-4 |
| Feronikeli - Drita | 0-0 |

Të hënën takohen:
13:00 Vushtrria - Ferizaj
13:00 Dukagjini - Flamurtari

Tabela

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Gjilani | 15 | 31 |
| 2. Ballkani | 15 | 31 |
| 3. Drita | 15 | 28 |
| 4. Prishtina | 15 | 27 |
| 5. Llapi | 15 | 24 |
| 6. Feronikeli | 15 | 23 |
| 7. Drenica | 15 | 21 |
| 8. Trepça '89 | 15 | 20 |
| 9. Ferizaj | 13 | 12 |
| 10. Flamurtari | 13 | 12 |
| 11. Vushtrria | 13 | 9 |
| 12. Dukagjini | 14 | 8 |

Në xhiron e radhës takohen: Ferizaj-Dukagjini, Flamurtari-Feronikeli, Drenica-Vushtrria, Prishtina-Trepça '89, Drita-Llapi, Ballkani-Gjilani.

## LIGA E PARË

| | |
|---|---|
| Onix - Dardana | 2-0 |
| Drenasi - Vitia | 2-0 |
| Trepça - Vëllaznimi | 2-3 |
| Liria - Istogu | 1-0 |
| Ulpiana - Arbëria | 1-1 |
| 2 Korriku - KEK-u | 2-1 |
| Besa - Malisheva | 2-1 |
| Ramiz Sadiku - Vllaznia | 2-0 |

Tabela

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Arbëria | 14 | 26 |
| 2. Liria | 14 | 25 |
| 3. Besa | 14 | 24 |
| 4. Drenasi | 14 | 22 |
| 5. Malisheva | 14 | 22 |
| 6. Istogu | 14 | 22 |
| 7. Onix | 14 | 20 |
| 8. KEK-u | 14 | 19 |
| 9. 2 Korriku | 14 | 19 |
| 10. Dardana | 14 | 19 |
| 11. Trepça | 14 | 18 |
| 12. Ulpiana | 14 | 17 |
| 13. Vllaznia | 14 | 16 |
| 14. Ramiz Sadiku | 14 | 14 |
| 15. Vitia | 14 | 11 |
| 16. Vëllaznimi | 14 | 10 |

### Besa e fiton derbin e Ligës së Parë ndaj Malishevës

